

Murteza Mutahhari

Koncepti i Republikës Islamike të Iranit

Një analizë e Revolucionit Islamik në Iran

Tiranë, 2014

Koncepti i Republikës Islamike të Iranit

Një analizë e Revolucionit në Iran

E para në serinë e koncepteve islame

Të gjitha të drejtat e këtij libri janë të rezervuara. Asnjë pjesë e tij, në asnjë mënyrë, nuk mund të përdoret, apo të riprodhohet pa lejen e botuesit, vetëm për qëllime propaganduese të Islamit, apo mund të përdoren thënie të shkurtra në artikuj dhe recensione.

Publikimi i parë është bërë më 1402 Hixhri/1982 pas Krishtit

Fondacioni “Be’thet”, Departamenti i Jashtëm

Rruga “Somaye” (midis Sheshit “Mofatteh” dhe Sheshit “Forsat”)

Teheran, Iran

Titulli: Koncepti i Republikës Islamike të Iranit

Autori: Murteza MUTAHHARI

Redaktoi: Dorina BASHA

Korrektura teknike: Jetmir ÇELA

Paraqitja grafike: Sabrie FEZA

Botoi: Shoqata FLLADI

PËRMBAJTJE E LËNDËS

Fjala e botuesit.....	7
Hyrje nga përkthyesi.....	9
Çfarë është një republikë islamike?.....	13
Pse nuk e quajmë atë Republikë Islamike Demokratike?.....	17
Çfarë ndodh me liritë demokratike të njerëzve, kur Republika Islamike, e drejtuar nga <i>Valiu Fakih</i> , kthehet në një teokraci?.....	25
Si mund t'i përballojë problemet bashkëkohore një republikë islamike, me ligje të shkruara një mijë e katërqind vjet më parë?.....	35
Pse të mos përpiqemi për një sintezë ideologjike ndërmjet Demokracisë dhe Socializmit - në njërën anë - dhe Islamit në anën tjetër?.....	43
Sa mirë mund të analizohet Revolucioni në Iran?.....	49
Sa mirë mund të forcohet dhe të zgjerohet Revolucioni Islamik në Iran?.....	71

Fjala e botuesit

Lëvizja jonë e brendshme islame i solli botës një skenë rilindjeje të ndikimit historik të Mesazhit Hyjnor. Ajo u dha njerëzve një ndjenjë mirëqenieje, në atë çka Islami përcjell, në kuptim të një qeverie të përgjegjshme dhe harmonike. Qasja ndaj të varfërve dhe të pambrojturve në mbarë botën premtonte një model qeverisjeje të bazuar në ndershmëri dhe drejtësi.

Pjesa tjetër e botës është duke pritur një model qeverisjeje si ai që po merr hov në Republikën Islamike të Iranit. Brezat e sotëm duan të kopjojnë modelin e një qeverisjeje të vërtetë dhe praktike. Vendet myslimane apo myslimanët kudo nëpër botë po bëjnë të njëjtën gjë. Ata duhet të kalojnë kufizimet e vendosura nga neokolonialistët perëndimorë dhe lindorë. Aftësia e tyre për të vetëvendosur mbi linjat islame duhet të fuqizohet.

Ata duan një fillim dhe një sistem të përgjegjshëm vetëqeverisës. Ata kanë nevojë për një sistem që nuk është kundër vlerave njerëzore dhe njerëzimit në tërësi. Kërkojnë një program të tillë që të jetë përtej vlerave materialiste. Me fjalë të tjera, duan të anashkalojnë modelet perëndimore e lindore të materializmit, autoritarizmin dhe mosvlerësimin e moralit që ndeshet në të ashtuquajturën "Bota e Tretë".

Shkurtimisht, bota e privuar, e shfrytëzuar dhe e shtypur, myslimane dhe jomyslimane po bëhet gjithmonë e më e vetëdijshme për fuqinë e të mirave universale që Revolucioni Islamik sjell. Shpresat dhe dëshirat e tyre duhet, gjithashtu, të realizohen. Si rrjedhojë, interesi i tyre për përvojën tonë është mëse i kuptueshëm.

Revolucioni ynë ka një rrugë të gjatë përpara. Ne kemi ende punë për të bërë, për të lëvizur nga rruga jonë të gjitha pengesat satanike.

Jemi ende në proces të njohjes dhe të zëvendësimit të të gjitha ndikimeve djallëzore, kështu që të gjitha përpjekjet e Revolucionit Islamik janë të qëndrueshme.

Megjithatë, çfarëdo që ne kemi arritur deri tani, ka ngacmuar interesin e të privuarve dhe të të dobëtëve në mbarë botën, qoftë edhe në mënyrë ideale.

Botuesi i këtij libri, që është një fondacion islam jofitimprurës, ndihet i motivuar nga përgjegjësia dhe interesi i lexuesve në mbarë botën. Ne e kemi për nder t'i ofrojmë lexuesit seri të mendimit islam, një format të lexueshëm në gjuhën angleze¹.

Ky libër përfaqëson botimin e parë të serive të konceptit islam. Për këtë, ne kemi zgjedhur një shpjegim të përpiktë, të dhënë nga i ndjeri martir Allame Mutahhari, në një intervistë televizive, marrë nga një lektor universiteti. Intervista është dhënë në atë kohë kur opinioni publik po kristalizohej në favor të Republikës Islamike, pak përpara sesa masat të votonin në mënyrë masive për të, duke shokuar forcat djallëzore.

Ne besojmë që të gjithë lexuesit, veçanërisht ata me formim intelektual, të gjejnë shpjegime rreth Revolucionit në Iran dhe të dallojnë me mjaft interes Republikën Islamike. Çdo gjë jepet pa rezervë, në mënyrë që bota të informohet sa më gjerësisht, në mënyrë korrekte dhe të qartë për Islamin dhe manifestimin praktik të tij nëpërmjet Republikës Islamike. Ne shpresojmë që në një të ardhme, të dobëtit dhe të privuarit, kudo që janë nëpër botë, të gjejnë në përpjekjet islame jo vetëm inkurajim, por edhe shembull. Gjithashtu, shpresojmë se disa nga lexuesit do të duan ta publikojnë këtë libër, duke e përkthyer në gjuhët e tyre, si një propagandë të mëtëjshme të koncepteve islame.

Ali Islami

Fondacioni "Be'thet"

1. Bëhet fjalë për botimin në anglisht të këtij libri, prej edhe nga është përkthyer në shqip. (Shënim i redaksisë)

Fjala e përkthyesit

Përafërsisht 2370 vjet më parë, Platoni themeloi një shkollë filozofie, të quajtur “Akademia”, vetëm pak kilometra larg Athinës. Kurrikula e saj ishte e bazuar në idetë e hedhura nga Sokrati, në kontekstin e trajnimit të mendjeve të atyre që mund të bëheshin “qeverisës-filozofë të drejtë të një qytet-shteti ideal”. Akademia e Platonit u përpoq të përmirësonte praktikat mësimore të kohës (orientuar drejt gjimnastikës për trupin dhe muzikës për shpirtin) dhe me një theks të veçantë, se si të mendosh me terma abstraktë.

Filozofia e saj theksoi “të vërtetat e përjetshme, idetë apo idealet, të përfshira në dialektikën, nën dritën e Idesë së të Mirës”. (“Ashtu siç është dielli për botën e të parit, ashtu është edhe e mira për botën e mendjes.”) Akademia e Platonit u përpoq të krijonte dashamirës të dijes, të cilët do të merrnin “kënaqësinë më të madhe” nga “bota më e pandryshuar e të vërtetës dhe e genies reale”, ndjekur nga “kënaqësitë e fitores, të nderit dhe nga përmbushja e dëshirave”.²

Sipas ideve të Sokratit, një drejtues-filozof i drejtë përfaqëson një produkt të një procesi fisnik të një edukate morale të orientuar, një proces që çon në asimilimin e njohurive, “në pastrimin e ekstravagancës”.³ Baza e moralit, në këtë rast, ndryshon sipas subjektit, që nga koha kur njeriu është akoma në çerdhe e deri në zhvillimin e një të ardhmeje tërësisht njerëzore, të kuptimit të koncepteve matematikore dhe të shprehjeve të dhëna.

Në kontekstin e “angazhimit të dyfishtë”, ndërveprimi i drejtësisë së Sokratit heq një paralele ndërmjet tipareve të një shpirti individual

2. John Clive Graves Rouse: Summary of the Republic (Book VI, IX), *Great Dialogues of Plato*, përkthyer nga W.H.D. Rouse, The New American Library, Inc., New York, Twentieth printing, f. 122, 124.

3. Ibid. (Book II), f. 119.

dhe partnerëve të tyre në shoqëri. Tiparet individuale ishin ndarë në: arsye, shpirt dhe pjesa e dëshirave. Pjesët partnere të shoqërisë janë:

1. një klasë sunduese filozofësh, statusi i të cilëve ishte goxha i korruptuar nga jeta aristokrate;

2. klasa ndihmëse, nderdashëse (e kamur, timokratike), e ushtarakëve;

3. klasa e oligarkëve, kënaqësidashësit, të aftë për të rënduar gjendjen e të varfërve, vetëm si rezultat i suksesit të rebelimit të tyre dhe eksperimenteve pa vlerë mbi shthurjet e lirisë demokratike, vetëm e vetëm për të vuajtur edhe një herë nga tirania.⁴

Në mënyrë mjaft të natyrshme, Sokrati besonte në superioritetin e njeriut-filozof. Kështu që, në mbështetje të sundimit të dashamirësve të dijës në një qytet, ai u duk se nuk përballonte më shumë se sa “sanksionin mitik të tri metaleve: ar, argjend dhe hekur”.⁵ S’është e çuditshme që thëniet filozofike, që i janë atribuar atij nga ndjekësit e tij, si Platoni, mbetën jobindëse, përveçse trajtimin të mendjes dhe jo materies si thelbësore. Pavarësisht nga kjo, forca e mendimeve provokuese të shpallura ka mbijetuar deri në ditët tona edhe ndër kulturat Perëndimore dhe Lindore, si dhe në degët e tyre në Amerikë e më gjerë.

Institucionet moderne të edukimit dhe të trajnimit synojnë të sjellin sa më shumë frymëzim nga Akademia e lashtë athinase. Vetëm në një kurs të përparuar, ata mund të marrin në konsideratë të flasin për Islamin. Përveç të gjithave, një filozofi islame gjithëpërfshirëse njerëzore e kapërcen jo vetëm materializmin, por edhe tiraninë, korrupsionin e aristokracisë, timokratinë, oligarkinë dhe njeriun demokrat apo socialist.

Koncepti i shtetit islam duhet të jetë i një interesi të veçantë, parë në kontekstin e mëposhtëm. Që të jemi më të saktë, kemi të bëjmë me konceptin e Republikës Islamike. Në një shtet islam, asnjë (mbret, diktator, klasë njerëzish apo një shtet i stilit evropian, “një shtet nacional” si i tërë) nuk mund të pretendojë pavarësi si një të drejtë absolute. Kur’ani e bën të qartë se Zoti

4. Ibid. (Book IV), f. 120; (Book VIII), f. 123

5. Ibid. (Book IV), f. 120.

e krijoi njeriun (43:87) si mëkëmbës të tij (2:30) në Tokë (29:61/23:84,85) dhe gjithashtu i nënshtroi atij (diellin, tokën dhe hënën) për nevojat jetësore të njeriut (29:61, 63/ 23:88). Si rrjedhojë, Uniteti Hyjnor (*Tehuid*) dhe sovraniteti i tij absolut mbi krijesat dhe krijimi i Tij, nuk mund të jetë kontradiktor me asnjë apo asgjë tjetër, apo të jetë i parëndësishëm.⁶

Nga sa u tha më sipër, në dispozitat e kushtetutës së Republikës Islamike të Iranit sanksionohet se asnjë ligj ekzistues apo i ardhshëm nuk duhet të jetë në kundërshtim me urdhrat kur'anorë dhe me parimet islame. Kjo është theksuar nga Al'lama Mutahhari, në kontekstin e monitorimit të rolit të *Vali Fakihi* (është dikush që njihet nga populli si një lider i jashtëzakonshëm në fushën e së drejtës islame. Njerëzit e shoqërive islame e marrin për të mirëqenë çdo gjë që thotë ai, kështu që ai njeri, qoftë një president apo një njeri i thjeshtë, duhet të pranojë të udhëhiqet nga doktrina e tij islame.)

Përveç specifikimit të rolit të *Vali Fakihi*-ut⁷, në termat e udhëheqjes ideologjike, përgjigjet e Mutahhariut ndaj pyetjeve të parashtruara rrotullohen rreth Republikës Islamike (duke e dalluar nga "Republika Islamike Demokratike") dhe natyrës islame, përmbajtjes dhe të ardhmes së Revolucionit Islamik në Iran. Ai refuzon prirjen e një republike islamike për t'u bërë autokraci teologjike. Thekson se njerëzit mbeten kureshtarë jo vetëm në

6. Apeli futurist për konceptin e sovranitetit të Zotit është trajtuar edhe në fanta-shkencën e sotme. Për shembull, në pjesën e tretë të trilogjisë *Duna*, Frank Herberti bën një "trazim" të disa koncepteve islame, siç mund të shihet nga ekstrakti i mëposhtëm, relativisht "i pastër": "Universi është i Zotit. Është një gjë e vetme, një përplotësi kundër të gjitha ndarjeve që mund të hamendësohen. Jeta e përkohshme, edhe ajo e vetëdijshmja, edhe e arsyeshmja, që ne e quajmë të ndjeshme, përbën vetëm një pikë të vogël në gjithësi."

Frank Herbert: *Children of Dune*, New English Library, London, 1977, f. 37.

7. Nuk mungojnë rastet kur konceptet islame janë keqkuptuar ose janë keqinterpretuar nga analistë perëndimorë. Për shembull, në një "analizë të fundit mbi përballjet e Islamit me botën perëndimore sot", "*Wilajetu'l-Fakihi*" është marrë në mënyrë shumë literale dhe me mendjemadhësi nga njerëzit. "Qeveria e teologëve" dhe i ashtuquajturi "Shtet Islamik Shi'it", cilësohet si *hierokraci* apo si sundim i klerikëve, si në:

G. H. Jansen: *Militant Islam*, Pan Books Ltd., London, 1981, f. 178.

zgjedhjen e një qeverie islame dhe Vali Fakih-ut, por edhe në forcimin e ligjeve islame, të cilat përmbajnë aftësinë për të sjellë ndryshime të brendshme në përputhje me kërkesat kur'anore.

Përveç të tjerash, një analizë e detajuar e kuptimit dhe e rëndësisë së termave: *Inkilab* apo revolucion, *Beenish Fitri* (këndvështrim personal në përputhje me natyrën më të lartë njerëzore) dhe *Beenish Abzari* (një këndvështrim i orientuar drejt mjeteve që pasqyrojnë mendjet mekanike apo përpjekjet materialiste) janë të domosdoshme. Përshkrimet e apeleve populiste të Imam Khomeinit, aftësitë e tij udhëheqëse, që çliruan fuqinë e shpirtave njerëzorë, duke transformuar ndjesitë e tyre historike të pavlera dhe të vetëmposhtura në një vetëdije të rinovuar për të shkuarën e tyre islame dhe me një sens më të thellë të rithirrjes së vetvetes në Islam, meritojnë, gjithashtu, një vëmendje të kujdesshme.

Gjatë përkthimit të materialit nga persishtja në anglisht është treguar një kujdes i veçantë për të mënjeluar shpjegimet e tepërta dhe për të qëndruar sa më pranë kuptimit origjinal. Në të njëjtën kohë, është mbajtur parasysh dhe përshtatshmëria në gjuhën angleze. Materiali i përdorur për përkthim është i njëjtë me atë të botuar në librin "Peiramoona Inkilab Islami".⁸ Po ashtu, janë përfshirë dhe shënime shpjeguese të Mutahharit, të marra nga diskutimet e tij më të hershme në Fakultetin e Shkencave Islame në Universitetin e Teheranit dhe në Mesxhid Farishtey në Teheran.

Shpjegimet e dhëna në paranteza janë përkthimet tona. Aty ku janë përdorur "s.a.s." dhe "a.s." tregojnë lutjet e myslimanëve për bekimet e Zotit mbi Profetin e Islamit, mbi profetët e tjerë dhe mbi imamët. Në gjuhën arabe shkruhen si më poshtë:

Sal'lAllahu 'alejhi ue alihii ue sel'lem - Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij! صلى الله عليه وآله وسلم
'Alejhi's-selam - Paqja qoftë mbi të! عليه السلام

M. K. Ali

Teheran, 16 Sh'aban 1402 h.

8. *Peiramoona Inkilab Islami*, Sadra Publications, Teheran.

-I-

Çfarë është një Republikë Islamike?

Intervistuesi: Me afrimin e referendumit, disa probleme ideologjike kanë marrë një vëmendje të veçantë nga njerëzit, veçanërisht nga intelektualët. Në këtë intervistë televizive, ne kërkojmë mendimin tuaj për këto pyetje vendimtare.

Pyetja e parë ka të bëjë me konceptet thelbësore të Republikës Islamike. Ky koncept mbase nuk është kuptuar mirë nga ata që përdorin vetëm nocione të dobëta për ta përshkruar atë. Për shembull, disa ndiejnë se mendimi apo rëndësia e Republikës është e bazuar në sovranitetin, në duart e publikut, një lloj vetëqeverisje e njerëzve. Në të vërtetë, struktura ideologjike islame përfshin çdo gjë që i është kushtuar Republikës, sipas një shpjegimi që synon t'i përmbledhë të gjitha, si kriteret islame të një *republike*, ashtu edhe nocionet më popullore të karakterit demokratik. Më konkretisht, ne ju pyesim:

Çfarë është një Republikë Islamike, sipas mendimit tuaj?

Mutahhari: Ne mund të mos bëjmë ndonjë përshkrim të detajuar të Republikës Islamike. Megjithatë mund të themi që dy fjalët, *Islamike* dhe *Republikë*, i referohen përkatësisht një tipi qeverisjeje dhe përmbajtjes së saj ideologjike. Ne jemi të gjithë në dijeni të tipave të qeverisjes, si në të shkuarën, edhe në ditët e sotme. Disa janë formuar nga monarki të trashëgueshme, që ne i njohim sot si monarki apo si sisteme perandorake. Të tjera vende kanë sisteme autokratike, aristokratike apo oligarkike, si dhe kapitaliste.

Sistemi qeverisës nga njerëzit e zakonshëm është një tip qeverisjeje, në të cilin njerëzit zgjedhin udhëheqësin e tyre. Nuk përbën asnjë diskriminim, në bazë të gjinisë, racës apo fesë. E vetmja kërkesë në këtë rast është që votuesit të jenë të një moshe madhore. Zgjedhjet përsëriten një herë në disa vjet, kështu që qeveritë janë të përkohshme. Votuesit mund t'i rizgjedhin të njëjtët pushtetarë për një mandat, dy, tre, madje dhe katër, sipas rastit dhe sipas rregullave kushtetuese. Por, ata mund të zgjedhin edhe të tjerë, që mendojnë se janë më të përshtatshëm për pozicionet publike.

Mbiemri *islamik* paraqet natyrën dhe përmbajtjen e qeverisë. Ai sugjeron se qeveria do të funksionojë në bazë të parimeve dhe rregullave islame.

Ne e dimë që Islami si fe simbolizon njëkohësisht një shkollë mendimi dhe një ideologji gjithëpërfshirëse. Ai mishëron një mënyrë të planifikuar jetese në aspektete shumëdimensionale dhe të lavdishme. Si rrjedhojë, qeverisja islamike nënkupton një formë qeverisjeje, në të cilën Presidenti zgjidhet nga vota e popullit për një periudhë të caktuar kohe dhe ideologjia e kësaj qeverie bazohet në Islam.

Pasaktësitë konceptuale për një Republikë Islamike shpesh vijnë nga supozimi i gabuar se çdo sovranitet nacional i drejtë, është i barabartë për të mos adoptuar politika specifike apo ideologji dhe në sinonim me mos aderimin në asnjë tërësi principesh të veçana intelektuale rreth botës, dhe principeve teorike në lidhje me një mënyrë të veçantë jetese.

Ata që mendojnë në mënyrë të gabuar, siç u tha më lart, thonë se një person nuk është i lirë dhe nuk jeton në Demokraci, kur e identifikon veten e tij me një parti, ideologji, një tërësi vlerash apo me një besim dhe që më pas kërkon zbatimin e politikave dhe rregulloreve përkatëse. Një përfundim i mundshëm i këtij keqkuptimi është nëse në një vend islamik, i përfaqësuar nga shumica, që janë myslimanë të devotshëm dhe/ose tërësisht të dhënë pas parimeve islame, pa pasur asnjë dyshim apo përpjekje për të justifikuar diçka, Demokracia është si pikësynim.

Demokracia është ngushtësisht e lidhur me sistemet e qeverisjes. Në një qeveri demokratike, njerëzit mund të ecin përpara sipas mundësive dhe aftësive të tyre. Megjithatë, nuk mund të përjashtohet që ata ta konsiderojnë veten e tyre të përjashtuar nga çdo shkollë e veçantë mendimi (apo që dikush të ketë pushtetin të mbyllë sytë e mendjes së dikujt ndaj çdo parimi të nënshkruar nga një shkollë mendimi) ose të veprojnë pa pyetur për pasojat.

Në kontekstin e mësipërm mund të ngrihen disa pyetje për përgjigje nga ata zotërinj që duket se nuk e kanë kuptuar si duhet thelbin e Republikës Islamike:

Së pari, a e kuptojnë ata se secili individ duhet të përsosë mënyrën e tij të të menduarit, për t'u bërë sa më demokratik? Anasjelltas, ata sugjerojnë se asnjë individ nuk duhet të pranojë apo të punojë për ngritjen e një shkolle të veçantë mendimi apo duhet të injorojë çdo parim thelbësor të bazuar në një shkollë?

Për më shumë, a e marrin ata parasysh faktin që çdo pranim joskeptik i menjëhershëm i një tërësie parimesh logjike, filozofike, shkencore apo fetare mund të nënkuptojë diçka që e dëmton Demokracinë? Apo ata konsiderojnë jodemokratik atë person që refuzon të besojë apo të pranojë çdo veprim që mund të përbëjë dyshim, sipas këndvështrimit të tij, ndërkohë nuk lejon as të tjerët që të dyshojnë rreth besimeve dhe mendimeve të tyre?

Cilado që të jetë përgjigjja për pyetjet e mësipërme, është për t'u pranuar fakti se për shumicën e popullsisë së Iranit, respektimi i besimit të tyre, Islami, dhe të besuarit me vendosmëri në parimet (pa iu nënshtruar procesit të vetëdyshimit apo skepticizmit) nuk nënkupton asnjë mëkat apo gabim. Ndoshta ajo që konsiderohet si mëkat ose gabim nga ana e tyre është fakti që përfaqësuesit e një shumice myslimanësh nuk lejojnë asnjë pakicë jobesimtarësh t'i pyesin për ndonjë justifikim rreth besimit të tyre.⁹

9. Vërejtje të ngjashme mund të jenë të vlefshme edhe për shoqëritë joislame. Për shembull, shoqëritë komuniste mund të mos e konsiderojnë si jodemokratik çdo pranim joskeptik të parimeve të komunizmit. Ajo çka shkon në kundërshtim me parimet demokratike është një lloj përgjegjësie

Për sa i përket çdo gjykimi nëse u është dhënë apo jo liri e mjaftueshme kundërshtarëve, ka të bëjë me të njëjtët njerëz që e konsiderojnë Demokracinë si sinonim i të mosbesuarit në një shkollë mendimi.

e jokomunistëve jashtë (dhe e disa kundërshtarëve brenda vendit), të cilët mund të pyesin për justifikimin e besimit dhe veprimit komunist (mund të përmendim p.sh., *Perden e Hekurt* ose pengesat për një bashkëjetesë të mirë me fqinjët jokomunistë).

-II-

P se nuk e quani atë “Republikë Demokratike Islamike”?

Intervistuesi: Në një ndër diskutimet e tij, Imam Khomeini u shpreh se nuk do të thotë as më shumë e as më pak se sa fakti që ai do të votojë për Republikën Islamike. Thënia e tij “as më pak”, me sa duket ishte theksimi i fjalës *Islamike*, si pjesë e Republikës Islamike. Kjo është e ngjashme me atë që ju theksuat në fillim të kësaj bisede, që *Islamike* nënkupton ideologjinë e Republikës. Me fjalë të tjera, kjo përcakton se parimet islame do të zbatohen në qeverinë e propozuar.

Duke iu referuar thëniet e Imamit “as më shumë”, dikush mund të arrijë në përfundimin se kjo, në dukje, është bërë për të mënjeluar konfuzionin që vjen nga përdorimi i një fjale tjetër shtesë: *Demokratike*, në nomenklaturën “Republika Islamike Demokratike”. Kjo mbase është bërë në mënyrë të tillë, që të mos sjellë ngatërresa në kuptimin e termit *Demokraci*, sipas botëkuptimit perëndimor me konceptualizimin e lirive demokratike sipas Islamit.

Ju lutem, a mund të shpjegoni më gjerësisht dhe të cilësoni dallimin në kuptimin, domethënien dhe konotacionin e frazave të lartpërmendura?

Mutahhari: Unë nuk pretendoj se mund të shpjegoj të gjitha nënkuptimet e thëniet të Imamit. Megjithatë, do të përpiqem të sqaroj disa nga nënkuptimet e tyre, që unë besoj se kanë të njëjtën pikëpamje me atë të Imamit.

Ashtu sikundër e dini, në Islam, liritë demokratike gëzohen nga individët. Megjithatë, nuk është e njëjta gjë si në demokracitë perëndimore. Dallimi qëndron në mënyrën e perceptimit të gjërave në Islam dhe në ideologjitë perëndimore.

Në frazën “Republika Demokratike Islamike”, fjala *demokratike* është e tepërt. Për më shumë, në një Republikë Demokratike Islamike, liritë dhe normat demokratike të gëzuara nga njerëzit mund t’i atribuohen gabimisht elementit *demokratik*. Me fjalë të tjera, nomenklatura e lartpërmendur është sugjестive e dy bazave të republikës: Islamike dhe Demokratike. Dikush mund të shkojë më tej dhe të thotë se kjo çështje u takon të drejtave të individëve dhe lirive demokratike që rrjedhin vetëm nga virtytet demokratike apo nga nomenklaturat demokratike. Atëherë, pjesa *islamike* nënkupton vetëm një seri bindjesh fetare ose praktikash tradicionale, në kuptimin e lutjeve dhe riteve të tjera fetare të ngjashme.

Ne duhet të theksojmë faktin se Islami i përfshin të drejtat individuale dhe liritë demokratike dhe, si i tillë, i përmban të dy termat, *Islamike* dhe *Demokratike*. Në të vërtetë, një shoqëri islamike nuk toleron dallime të tilla si ato të mësipërmet. (Siç thotë dhe një thënie persiane: “Kur ke njëqind, (do të thotë që) ti ndërkohë i ke nëntëdhjetë.”)

Për më tepër, koncepti i të drejtave individuale dhe i lirive demokratike në filozofitë socio-politike të Perëndimit, siç përmendet nga perëndimorët jomyslimanë (apo lindorë) rrjedh nga perspektiva ideologjike tërësisht të ndryshme nga ato të Islamit. Prandaj, ne nuk mund të vëmë re ndonjë dallim të lehtë të ideologjive ose të lëmë vend për ndonjë keqkuptim.

Sipas degëzimit të konceptit të lirive dhe të drejtave individuale, ata thonë se njeriu ka lindur i lirë dhe si i tillë është përcaktuar që ta mbajë këtë liri. Po t’i pyesim se, përse nuk mund të themi të njëjtën gjë, për shembull, për një dele, ata japin argumente të ndryshme. Për mendjet perëndimore, liria individuale është e rrënjosur në prirjet dhe dëshirat njerëzore. Kur ata flasin për dëshirat dhe përcaktimin e qenieve njerëzore, nuk i dallojnë këto nga prirjet e tyre.

Sipas mënyrës perëndimore (materialiste) të të filozofuarit, njeriu është një entitet me një seri dëshirash dhe kërkesash që

përfaqësojnë *raison d'etre* e jetës së tij. As mos e çoni nëpër mend se këto dëshira mund të plotësohen pa lirinë individuale të të vepruarit. Kufizimi i vetëm për lirinë individuale të individit është nevoja e individëve të tjerë, për të njëjtën gjë dhe jo ndonjë rregull i pëgjithshëm.

Liria individuale në mënyrën e shpjeguar më lart, p.sh., konceptimi i saj në kuptimin se njeriu i lindur është i lirë dhe karakterizohet në mënyrë të natyrshme nga prirje dhe dëshira dhe, si i tillë, ai duhet të mbetet i lirë. (si në një park natyror, i ngjashëm me kombet-shtet)

Megjithatë, qëndron fakti se njeriu, në të vërtetë, duhet të përballojë natyrën e tij kafshërore. Njeriu është një qenie njerëzore dhe një kafshë virtuale në të njëjtën kohë. Si qenie njerëzore atij i është dhënë inteligjenca më e lartë ndër të gjitha krijesat e tjera tokësore.

Si rrjedhojë, ai është i aftë të mendojë dhe të kontrollojë instinktët dhe dëshirat e tij kafshërore. Ai mund të përballojë më së miri instinktët, dëshirat apo egoizmin e tij, në një mënyrë tërësisht njerëzore.

Pa dyshim, njeriu është i aftë t'u veshë virtyte instinkteve të tij të lindura. Në të njëjtën kohë, ai mund të perceptojë vlerat njerëzore, si: të vërtetën, të bukurën, moralin dhe të tjera, që reflektojnë të njëjtat vlera në jetën e gjithsecilit.

Është një lidhje e anasjelltë ndërmjet karakteristikave njerëzore dhe kafshërore, që në mënyrë të pashmangshme e tërheqin ekzistencën natyrore të njeriut. Sipas Kur'anit famëlartë, natyra dypolare e njeriut është e orientuar përkatësisht drejt (urtësisë së) arsyes së tij dhe drejt (cilësisë së) sensualitetit\materializmit të tij. Me fjalë të tjera, është orientuar drejt prejardhjes shpirtërore të jetës së njeriut si një realitet kuptimplotë nga Qenia Supreme në njërën anë dhe manifestimit të tij sensual\material në anën tjetër.

Për rrjedhojë, është absurde të mendosh se një pjesë e natyrës njerëzore mund të çlirohet tërësisht nga pjesa tjetër. Kjo ndodh, pavarësisht, nëse është pjesë e anës sublime apo jo.

Çdo përpjekje për të edukuar një pjesë të natyrës njerëzore (shpirtërore apo materiale) në izolim, do të nënkuptojë në mënyrë të pashmangshme një dobësi dhe kufizim të ndërjegjes së tjetrit.

Kur ana materiale e natyrës njerëzore është izoluar, si një anë kryesore, që të lejohet lira e asaj në bazë të të drejtave individuale në një Demokraci, është e pashmangshme ajo me të cilën ne do të përballemi, siç është legalizimi i homoseksualitetit me shumicë vote në parlament (rasti Britani e Madhe). Kjo tregon se opinioni i shumicës mund ta bëjë homoseksualitetin të respektueshëm, si pjesë të bashkëjetesës demokratike.

Njohjet ligjore të homoseksualitetit të lartpërmendur janë tregues të dy gjërave: së pari, kanë miratuar faktin se shumica e njerëzve nuk ishin kundërshtues të mbizotërimit të praktikave homoseksuale ndërmjet tyre. Dhe, së dyti, ka themeluar faktin se Demokracia e bën si detyrë të vendimeve zyrtare dhe ratifikimeve ligjore çdo gjë që do shumica.

Për më shumë, sanksionet demokratike të homoseksualitetit duhet të vërtetojnë se nuk kemi të bëjmë me një rrugë të drejtë (*As-Sirat al-Mustakim*) apo me zhvillim tërësor të një logjike pozitive për të përcaktuar se çfarë është natyrore apo jo sipas normave të sjelljes njerëzore. Me rastin e aplikimit të kriterëve thelbësore, veprimi rezultat do të ishte në termat e korrektesës së nevojshme dhe drejt ndalimit të çdo sjelljeje njerëzore.

Në mënyrë që të mos u lënë vend kundërshtimeve me baza morale, ata e gjejnë të volitshme të thonë se të drejtat thelbësore, nuk ekzistojnë. Përveç të tjerash, ata mendojnë se çdo gjë që ka lidhje më shumicën e njerëzve, është e drejtë. Kjo lloj logjike është reminishencë e asaj që Mulla Nasraddini ka vërejtur dikur. Ai ishte duke udhëtuar me mushkë, kur dikush e pyeti se ku po shkonte. Ai u përgjigj menjëherë se po ndiqte të njëjtën rrugë si dhe mushka. Në të njëjtin kontekst, mund të pyesim se ku po shkon Perëndimi që ndjek parimet demokratike? Në mënyrë të ngjashme, përgjigjja do të ishte se po ndjek drejtimin e instinkteve të tyre!!! Lloji i demokracisë dhe i lirive individuale të parapara në

Islam është e kundërta e atyre të Perëndimit. Demokracia islame është e bazuar në integritetin e lirive dhe të drejtave njerëzore. Ajo nuk i venit ndjesitë njerëzore në ndjesi thjesht sensuale.¹⁰

Nga ana tjetër, Islami nuk e favorizon jetën askete. Po ashtu, nuk është përkrahëse e represionit të instinkteve njerëzore. Në vend të kësaj, Islami i ndihmon individët të organizojnë dhe të menaxhojnë jetën e tyre sipas një mënyre harmonike filozofike, intelektuale ose shpirtërore dhe sociale. Ndjekësit e tij janë të aftë të rregullojnë instinktët e tyre sipas një mënyre sa më njerëzore.

Islami synon t'i nxisë përpjekjet njerëzore drejt vetëpërsosjes dhe humanizmit, në termat e kultivimit të një natyre më të lartë të instiktive dhe ndjenjave të denja për njerëzit. Kur themi se demokracia është një pjesë integrale e Islamit, ne nënkuptojmë se Islami përpiqet të sigurojë liri të vërtetë për të vepruar dhe për të ndërvepruar si një qenie e vërtetë njerëzore, pa e bërë veten në asnjë çast subjekt të urdhrave sensualë të trupit.

Me fjalë të tjera, Islami synon të çlirojë ndjesitë e të qenit njerëzor dhe të përcaktojë kufijtë e duhur për sjelljet materialiste. Kjo pikë mund të gjykohet nga vëzhgues me përvojë, në bazë të dy shembujve të ndryshëm nga historia.

10. Në rastin e një "vendi të lirisë" të Perëndimit, ne kemi dëgjuar se një demonstratë publike e zhvilluar kundër homoseksualitetit në Iran është parë si demonstratë kundër ligjeve islame. Ata kanë protestuar kundër ndëshkimit të Islamit, duke thënë se ka shkuar kundër konceptit të lirisë individuale dhe të demokracisë.

Në të vërtetë, nga pikëpamja islamike, këto lloje lirish që çojnë në lejimin e homoseksualitetit në Perëndim, synojnë të dobësojnë dhe të vënë në rrezik të drejtat dhe liritë themelore të individit. Për ta, çlirimi i kafshërores të njeriut e bën një të burgosur kriminel me shpirt sublim njerëzor.

Kur'an'i thotë se ata që ata që nuk kërkojnë dhe nuk mendojnë asgjë, por vetëm kristalizimin e lirive të tyre, në drejtim të kënaqësive të tyre seksuale ose të nevojave të tyre trupore, në të vërtetë e kanë humbur kuptimin e të qenit njeri, gjë që ndodh në momentin kur ata e harrojnë Zotin. Me fjalë të tjera, ata kanë hequr dorë nga përkushtimi ndaj Zotit dhe mendojnë vetëm për veten, siç është përcaktuar edhe në këtë varg kur'anor: "*Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).*" (Kur'an, 59:19)

Pushtimi i Babilonisë nga Kiri u pasua nga dekreti i tij, sipas të cilit njerëzit e nënshtruar nga pushteti i tij mund të ndiqnin lirisht praktikat dhe besimet e tyre, cilatdo qofshin ato, idhujtari apo paganizëm. Liritë e pakufishme të adhurimit të dhëna në Babiloninë politeiste mund t'i përmbushnin kriteret e lirive demokratike të vendeve perëndimore. Prandaj, nuk është e çuditshme që Perëndimi i atribuon Kirit cilësitë e një lideri të madh, të një dashamirësi të lirisë, që respektonte dëshirat dhe ndjenjat e popujve nën sundim. Prirje personale përmbajnë si liritë e dhuruara babilonasve, ashtu edhe ato të demokracive perëndimore.

Për krahasim, ne mund të sjellim një shembull tjetër nga historia. Ka të bëjë me ndërgjegjen e Profetit Ibrahim (a.s.) (në dallim nga përçmimi) për të mos qëndruar indiferent ndaj problemit të idhujve. Ai donte ta çlironte popullin e tij nga pasojat djallëzore të paditurisë së tyre. Ia doli me sukses, pasi shkatërroi idhujt dhe i drejtoi ata drejt vetënjuhjes, siç është përcaktuar në Kur'an.

Veprimet e sipërpërmendura të Profetit Ibrahim (a.s.) përfaqësojnë diçka që largohet nga parimet e lirisë dhe të demokracisë, sipas pikëpamjes perëndimore. Për demokracitë perëndimore është e lejueshme që njerëzit të praktikojnë çfarëdo që ato besojnë, si pjesë e lirive të individit.

Qartësisht, logjika e protagonistit të tipit Perëndimor është e kundërta e Profetit. Përveç të tjerash, profeti i fundit Muhamedi (s.a.s.), në kthimin e tij triumfues në Mekë, nuk tha: "Lejojini mekasit të bëjnë atë që kanë bërë deri tani dhe se kjo nuk ka lidhje me interesat e mia." Ai nuk e toleroi idhujtarinë në mënyrë që ajo të përfaqësonte liritë e tyre të zgjedhjes dhe si e tillë të ishte e denjë për respekt dhe liri të vazhdueshme.

Ai nuk e bëri një gjë të tillë. A nuk e tregoi Profeti i Islamit kuptimin e vërtetë të të qenit njeri i lirë, kur ai shkatërroi idhujt e Qabesë? Nëse po, çfarëdo që quhet si e rëndësishme për të drejtat individuale dhe liritë e brendshme të individit, duket se është e

bazuar në promovimin e nevojave të vazhdueshme që njeriu ka gjatë zhvillimit të tij si qenie njerëzore. Për më shumë, të drejtat individuale janë pjesë e të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga humanizmi i njerëzimit dhe jo nga ndonjë çlirim individual i dëshirave të pabindura të tij.

Sipas Islamit, çdo situatë demokratike duhet gjithmonë të marrë në konsideratë lirin dhe mbrojtjen e humanizmit të njeriut. Kjo është e nevojshme për të shmangur të gjitha pasojat e dëmshme të egoizmit/dhe ose të çdo praktike jetese negative të individëve apo të shoqërisë. Në të kundërt, një shoqëri në demokracitë perëndimore synon të arrijë të promovojë metoda të tilla, si talentin e anëtarëve të saj për të përfituar sa më shumë kënaqësi nga ekzistenca e tyre biologjike e papenguar.

Fjala *demokraci* nuk është përmendur nga Imami në referencën e qartë të “Republikës Islamike”, mbase për shkak të mospëlqimit të tij të mirënjohur ndaj ndjekjes në mënyrë të verbër të modeleve perëndimore. Imami e ka parë gjithmonë si të papërshtatshme që populli ynë të kërkojë frymëzim te perëndimorët. Ai e quan të padëshirueshëm çdo imitim që u bëhet perëndimorëve, si për nga morali i njerëzve, ashtu edhe për nga shpirti i tyre revolucionar.

Madje, Imami mund të ketë ndier që çdo përdorim i fjalës “*demokraci*” do të ishte një përpjekje e njerëzve për të rivendosur identitetin e tyre kulturor. Në kulturën tonë tanimë është përfshirë thelbi i lirisë demokratike, prandaj, nuk kemi pse të ndjekim shembullin e të tjerëve.

-III-

Çfarë ndodh me të drejtat demokratike të njerëzve, nëse Republika Islamike e drejtuar nga *Vali Fakah-u*, kthehet në teokraci?

Intervistuesi: Në shpjegimet e lartpërmendura, ju na lini të kuptojmë se qeveritë demokratike janë të bazuara në epërsinë e njerëzve, e cila, siç dihet, ka qenë një ndër rrjedhojat më të rëndësishme të revolucionit demokratik. Nëse është kështu, a nuk mendoni se çdo zhvillim i konceptit të Republikës Islamike (në kuptimin e një demokracie pa kushte), mbase rastësisht mund të shkojë drejt teokracisë dhe t'ia kalojë të drejtat e njerëzve sovranitetit të shtetit?

Me fjalë të tjera a nuk konsideroni që çdo pikpamje progresive për fuqinë e një vendi është e ardhur nga sovraniteti i njerëzve dhe meriton të jetë lehtësisht e pranueshme, pa shkuar në një diskutim dukshëm të paqartë rreth rolit suprem të *Wilajetu'l-Fakah*, siç parashihet në një Republikë Islamike.

Mutahhari: Shkurtimisht, sipas argumentimit tuaj të gjithë njerëzit e Iranit, në një revolucion kushtetues, kanë të drejtë të jenë pjesë e paepur e legjislativit, gjyqësorit dhe ekzekutivit. Pra, nuk do të ishte e arsyeshme t'ia besojë të drejtat e lartpërmendura një grupi personash apo një personi. Për më shumë, ju thatë se në një Republikë Islamike, e drejta u është dhënë teologëve, apo, sipas fjalës së disa të tjerëve, autokracisë teologjike. Ju keni dalë në përfundimin se një Republikë Islamike që shkon drejt një autokracie teologjike, do të jetë kundër të drejtave të njerëzve dhe epërsisë në nivel kombëtar dhe, si e tillë, do të ndërtohet si një akt reaksionar.

Në kundërpërgjigje, duhet të vihet në dukje se populli i Iranit mund t'i mbajë të drejtat e tij të patjetërsueshme të epërsisë në nivelin kombëtar, të kërkuara nëpërmjet revolucionit kushtetues të tyre.

Është kështu sepse nga ata nuk mund të pritet kurrë që të marrin në konsideratë nevojën për të ri-orientuar dhe përshatur ligjet ekzistuese para revolucionare duke u adaptuar principet dhe standartet bazike islamike, do të ishtë e padenjë për supermacinë e tyre në nivelin kombëtar.

Si rrjedhim, nevoja për riorientim të ligjeve ekzistuese drejt Islamit është theksuar në Kushtetutë. Faktikisht, Kushtetuta përcakton se nuk mund të ekzistojë asnjë ligj që bie në kundërshtim me parimet e Republikës Islamike. Pikërisht për këtë arsye, në Kushtetutë janë parashikuar Këshilli i Mbrojtësve (të Kushtetutës) dhe pesë teologë të shquar. Njerëzit përgjegjës për revolucionin nuk i kanë kundërshtuar asnjëherë kushtet dhe direktivat e Kushtetutës. Dhe për më tepër, njerëzit e zakonshëm nuk kanë qenë të aftë të bënin ndonjë dredhi ligjore.

Pa e menduar, ata parapëlqyen (nëpërmjet votave të tyre) që ligjet ekzistuese të ishin në përputhje me parimet e ndritura islame.

Zbatimi i ligjit mund të jetë i nevojshëm për vetë njerëzit duke pasur për të një konsideratë të lartwë. Mbase ata mund të vënë në zbatim ligjet aktuale apo ligjet që i kanë formuluar vetë në një mënyrë të përshtatshme. Ata mund ta pranojnë një ligj të shkruar nga një filozof, jo për të folur për mësimet hyjnore-frymëzuese të Islamit, por për çdo gjë në mirëbesim.

Në këtë kuptim, çdo karakterizim që i është bërë Demokracisë më përpara, nuk do të jetë i papajtueshëm me sovranitetin e njerëzve, për të cilin ju thatë se gjen zgjidhje në Kushtetutë. Ose, për këtë qëllim, ndikimi i tij nuk do të jetë negativ, madje as për të gjitha parimet demokratike. Kjo ndodh sepse asnjë parim demokratik që ka një shoqëri, nuk duhet të rritet nën dritën e një ideologjie të veçantë apo shkolle mendimi.

Në të vërtetë, ne shohim se partitë politike zakonisht e lidhin

veten e tyre me një ideologji të veçantë dhe nuk e konsiderojnë këtë fakt si diçka që bie në kundërshtim me ideologjitë dhe parimet demokratike, të cilat ata mund t'i mbivlerësojnë.

Për më shumë, kuptimi i gabuar se çdo karakterizim islam i Demokracisë është i papërshtatshëm për frymën e Demokracisë, rrjedh nga mundësia që koncepti i tyre për të, të jetë ai i dhënë që në shekullin e tetëmbëdhjetë. Në atë shekull, Demokracia ishte e përqendruar në të drejtat e njeriut. Më vonë u ndërtua si diçka që u përkiste problemeve aktuale të jetës, përfshirë ushqimin, strehimin dhe veshmbathjen, si dhe e përqendruar në liritë e zgjedhjes së njeriut, sipas nevojave materiale të tij.

Ata që ushqejnë idenë e gabuar të shprehur më lart, tentojnë të harrojnë që e drejta njerëzore mund të përfshijë edhe prirjet njerëzore drejt spiritualitetit, në terma të besimit, dhe aspiratave materialo-pothuajse-shpirtërore. Ata duket se po e mbivlerësojnë pozicionin nga ku po ndodh ngritja e arritjeve njerëzore përtej ballafaqimit me instiktet psikologjike, apo edhe çdo përpjekje ndaj kërkesave fizike dhe socioekonomike. Përsosmëria njerëzore mund po ashtu të drejtohet drejt fesë, besimit dhe përtej dëshirave të zjarra materiale.

Gabimi i tyre është i kundërt me atë të bërë nga khavarixhët, të cilët keqndërtuan referencat e Kur'anit rreth autoritetit të fundit duke gjuikuar se pushteti absolut për të vendosur është vetëm tek Allahu; në suren "Jusuf" 12:40 thuhet: "*Ini'l-hukmu il'la lil'lah*" - "**Vendimi i përket vetëm Allahut**". Ata dhanë përshtypjen se edhe funksionet më të parëndësishme njerëzore dhe të vetëqeverisjes ishin një funksion Hyjnor.

Siç është thënë nga Hazreti Ali (a.s.), sovraniteti (*hakimije*) i Allahut, siç përmendet në Kur'an, tregon një ndër parimet më thelbësore.

Megjithatë, çdo rrjedhojë e dalë prej saj dhe që mund të mohojë vetëqeverisjen njerëzore, mund të sjellë një tërësi keqinterpretimesh të kuptimit më thelbësor të parimit kur'anor të sipërpërmendur. (*Kelimetu hakkin juradu biha'l-batil* - "Fjalë e drejtë, me anë së cilës kërkohet e kota.")

Ata zotërinj që pohojnë ekzistencën e një kontradikte ndërmjet parimeve të qeverisjes kombëtare nga njëra anë dhe atyre të pasqyruara në formulimin e një shkolle të veçantë mendimi në anën tjetër, veprojnë gjithashtu gabim. Për ta është e rëndësishme të imagjinohet se asnjë ligj nuk mund t'i anashkalojë parimet kushtetuese eksplicite, kështu që janë në përputhje me shpirtin e Islamit dhe janë diçka e ligjshme. Nëse po, sjellja e tyre është në kundërshtim me shpirtin e kushtetutshmërisë, madje edhe me atë të sovranitetit kombëtar.

Tani, përderisa pyetja juaj përmend hamendësimin se një Republikë Islamike mund të vendosë të drejtat e njeriut në një pedestal të lartë të sovranitetit kombëtar, unë mund të them se pjesa dërrmuese e popullit iranian e ka vendosur që e ardhmja e saj dhe e vendit të jetë me natyrë dhe me përmbajtje islamike.

Përpyekja e popullit iranian nuk ka qenë kundër mbizotërimit politik dhe kolonial të ekonomisë. Por një qëndrim kundër futjes së ideologjive perëndimore, si dhe keqdrejtimeve të tyre, për sa u përket koncepteve të lirisë, të demokracisë, të socializmit, të qytetërimit apo të një qytetërimi të madh, të zhvillimit dhe të modernizimit, ndërmjet të tjerëve të ngjashëm.

Miliona iranianë që mbajtën sloganin e "Republikës Islamike" në demonstratat historike kundër regjimit të mëparshëm, me siguri deshën që të vendosnin vulën e tyre, më shumë se sa atë të kulturës së tyre, në Revolucionin (që po vazhdon). Ne e dimë se identiteti kulturor i një vendi është ai i lidhur thellësisht me shpirtin dhe këta njerëz përpiqen ta ruajnë identitetin e tyre kulturor, që është Islami. Ata që e kanë larguar veten e tyre nga Islami, vazhdojnë të jenë pjesë e shoqërisë dhe po ashtu, të jenë dhe të mbrojtur. Në të vërtetë, ata janë jo më shumë sesa të huaj, të cilët janë vetëndarë nga kultura e njerëzve të tyre, nga shpirti dhe nga dëshirat e tyre.

Nëse kërkesat e vetë njerëzve anashkalohej nga Republika Islamike, duke prekur sovranitetin kombëtar, ne duhet të themi se republika është një propozim i pamundur, sepse vazhdimësia e

saj përfshin gjithmonë disa kontradikta apo gjëra të tjera. Askush nuk do që t'i detyrojë ndonjë republikë karakterin islam, nëse kjo bie në kundërshtim me vullnetin e njerëzve. Vetë njerëzit e kërkojnë një gjë të tillë.

Në të vërtetë, lëvizjet popullore për një Republikë Islamike u bënë të qëndrueshme nga vetë njerëzit në ditën e madhe historike të sipërpërmendur (dita e demonstratave të mëdha publike). Publiku këmbënguli dhe kërkoi që fushatat e tyre të fuqishme të çonin në themelimin e Republikës Islamike. Republika Islamike ka ardhur për të theksuar dy ndryshime të mëdha, të cilat kanë të bëjnë me situatën negative dhe me kërkesa të tjera pozitive. E para, ka të bëjë me rrëzimin e traditës monarkike 2500-vjeçare dhe e fundit ka të bëjë me restaurimin e vlerave monoteiste islame.

Pozicioni i *Vilajetu'l-Fakih*-ut dhe roli tij në një Republikë Islamike është i ngjashëm me atë të shpjeguar më lart. *Vilajetu'l-Fakih* nuk është bërë për të prezantuar *fakih*-un (juristin islam) si kryetar apo përgjegjës ekzekutiv, apo si një udhëheqës aktual të një qeverie islame. Roli i *fakih*-ut në një vend islam (d.m.th., një vend ku njerëzit janë të angazhuar dhe të bashkuar në pranimin e ideologjisë islame) është ai i një ideologu dhe jo i një udhëheqësi. Detyra e një ideologu është të mbikëqyrë dhe të vëzhgojë zbatimin e drejtë dhe korrekt të ideologjisë. Pra, është një rol që sigurohet nga virtytet e zotësive të tij ideologjike, kështu që për të vlerësuar dhe për të vendosur një kandidaturë për atë post, kreu i një Qeverie Islame, që nënkupton marrjen e përgjegjësisë kryesore që qeveria të punojë dhe të ecë në përputhje me ideologjinë islame.

Shpjegimi i rolit të *Vilajetu'l-Fakih*-ut, si pjesë e gjeneratave të mëparshme (e ditëve të Kushtetutës) dhe të së tashmes, nuk ka qenë i tillë, që *Fakih*-ët të mund të marrin mbi veten e tyre tagrin e drejtimit dhe të administrimit të një vendi islam. Në të vërtetë, përgjatë shekujve, mendimi i njerëzve për *Vilajetu'l-Fakih*-un, si një faktor i rëndësishëm, për sa u përket kompetencave apo me

fjalë të tjera funksioneve publike në një qeveri islame, ka lidhje me përhapjen dhe zbatimin e ligjeve dhe kritereve islame.

Në këtë mënyrë, Imam Khomeini ka përmendur në një urdhër të adresuar kryeministrit të qeverisë provizore: "...Në përputhje me Ligjin e Sheriatit dhe në përputhje me atë që më është besuar mua nga një shumicë e qartë njerëzish, unë do të përcaktoj kreun e shtetit..."

Vilajetu'l-Fakih është një zyrë me juridiksion ideologjik. Në të vërtetë, janë njerëzit ata që e zgjedhin *fakih*-un e tyre. Ky fakt, në vetvete, manifeston demokraci. Mund të ketë raste që përcaktimi i një zyre të *Vilajetu'l-Fakih*-ut është me përzgjedhje, por mund të jetë e mundur që për një *Fakih* të ndiqet nga të përzgjedhurit e tij, ne mund të themi se këto praktika mund të jenë në kundërshtim me parimet demokratike. Megjithatë, është fakt se njerëzit mund të zgjedhin një *marxha'* (këshilltar *fakih* - autoritet fetar që pyetet për çdo çështje fetare jetike) për zyrën publike të *Vilajetu'l-Fakih*-ut.

Autoriteti i Sheriatit të Imamit (*fakih*) manifeston vetveten kur miratohet nga angazhimi vendimtar i njerëzve për Islamit si një shkollë e veçantë mendimi dhe si një ideologji e mirëformular. Njerëzit e njohin juridiksionin e tyre dhe i japin besueshmëri në kompetencat e tij të veçanta për të vepruar sipas natyrës islame dhe për të përmbushur detyrat.

Në të vërtetë, autoriteti ose mbikëqyrja e Sheriatit duhet të përfaqësojë garancinë ideologjike për popullin. Një e drejtë sipas ligjeve zakonore apo laike është e përfaqësuar nga sovraniteti kombëtar apo supremacia e popullit. Është e njëjta e drejtë si ajo e dhënë për zgjedhjen e liderëve, që mund të meritojnë votën e fshehtë të tyre.

Ti përmende mundësinë, nëse ka një të tillë, që Republika Islamike mund të bëhet një qeveri teologjike. Këtu duhet të ekzistojë një gabim ndërmjet një qeverie që është islame dhe asaj të udhëhequr nga një klasë teologësh. A mund të të pyes se si është e mundur që fjalës *islamike* t'i jepet konotacioni i çfarëdolloj

udhëheqjeje nga kleri. A përfaqëson Islami një ideologji apo një prerogativë të cilitdo prej specialistëve teologjikë të saj? A përqendrohet Islami te njeriu dhe te perspektivat njerëzore universale?

Apo është vërtet çështja që edhe nëse mendimtarët tanë të vendosen ballë për ballë me konceptin e Republikës Islamike apo të dëgjojnë për të, kambana që bie në mendjet e tyre është ajo që praktikisht është sinonim me një republikë të *Akhund*-ve (teologëve) apo të *Mullah*-ve? A nuk po e marrin të mirëqenë faktin këta zotërinj, se ndërmjet Republikës Islamike dhe sistemeve të tjera republikane ka vetëm një ndryshim dhe i atribuohet së parës si një republikë në të cilën *Mullah*-ët kërkojnë pozita udhëheqjeje dhe zënë pozicione të ndryshme?

Supozojmë se ajo çka ata i atribuojnë një Republike Islamike i detyrohet faktit se ata nuk njohin asgjë tjetër më të mirë dhe vetëm mund të çuditen.

Megjithatë, nëse ata bëjnë një gjë të tillë si njerëz të arsyeshëm, dhe e konsiderojnë të arsyeshme të kundërshtojnë dhe përcmojnë, pavarësisht këndvështrimit objektiv të tyre në lidhje me çështjen, për ta vetëm mund të ndihet keqardhje.

Sot, çdo i ri që shkon në shkollë e di që një Republikë Islamike i përket regjimit republikan të një shoqërie islamike. Ai e di se një shoqëri islame është e bazuar në konceptin e unitetit të Zotit (*Teuhid*).

Për të, uniteti absolut me Zotin do të thotë që çdo gjë në botën natyrore është e ardhur nga Ai dhe kthehet tek Ai. Është një dije e përgjithshme, që kjo perspektivë monoteiste e Islamit është e lidhur me një ideologji gjithëpërfshirëse, që pasqyrohet me konceptin e unitetit të Zotit.

Koncepti i unitetit të Zotit, siç pasqyrohet në ideologjinë islame, hedh bazat e statutit konceptual, për të sjellë unitetin dhe ideologjinë e sjelljes njerëzore në nivelin social dhe individual.

Nevojat për të sjellë unitetin njerëzor janë përmendur nga Profeti (s.a.s.) në letrat e tij shpjeguese për shumë personalitete të

botës të asaj kohe, që e shpjegon mesazhin e Kur'anit të Shenjtë si më poshtë:

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِّنْ دُونِ اللَّهِ فَإِن تَوَلَّوْا فَقُولُوا اشْهَدُوا بِأَنَّا مُسْلِمُونَ

“Thuaj: ‘O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!’ Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: ‘Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!’” (Kur’an, 3:64)

Fraza *“ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush”* përcakton zbatimin e barabartë të unitetit hyjnor te njerëzit. Fjalët *“se do të adhurojmë vetëm Allahun”* vënë në dukje nevojën për të miratuar pikëpamjen dhe sjelljen ndaj konceptit të unitetit hyjnor. Fraza *“dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin”* gërsheton barazinë e njerëzve dhe nevojën për ta pasqyruar këtë në ndërveprimin shoqëror, i cili përçon të njëjtën rëndësi sociale, ashtu siç edhe përcaktohet nga koncepti i demokracisë. Dhe për më shumë, pasqyrojnë formën më origjinale të saj.

Disa njerëz mendojnë se një *Republikë Islamike* është treguese e ndarjeve sociale. Për shembull, mund të përmendim klerin si një klasë mbizotëruese. Kjo shkon pashmangshmërisht drejt filozofisë materialiste dhe ndërgjegjes klasore të shoqërisë. Duke pasur mbiemrin *Islamike* që nuk ka qenë më përpara i bashkangjitur me *Republikën*, mbase ka treguar pabarazi përsa i përket klerit dhe për të përmendur se qeveria duhet të jetë në duart e njerëzve dhe jo të ndonjë klase të caktuar shoqërore.

Të bëhet ajo që duhet bërë. Një *Republikë Islamike* nuk thekson kurrë ndarjen e klasave në shoqëri. Natyra dhe përmbajtja e saj duhet të jetë gjithmonë islamike në ideologji të perspektivës që përcaktohet më sipër.

As mbiemri *islamike* nuk mund të ketë i vetëm kuptimin që

ka fjala *Republikë*, në çfarëdo kuptimi thelbësor nuk e klasifikon dot një term të tillë pa i veshur kontradiktë. Duhet shikuar në thellësi të këtij klasifikimi dhe duhet vendosur nëse ka apo jo ndonjë kufizim të veçantë apo orientim klasor, që përbën një pjesë integrale të kuptimit.

-IV-

Si mund t'i përballojë problemet moderne një Republikë Islamike, me ligje të shkruara njëmijë e katërqind vjet më parë?

Intervistuesi: Situatat socio-ekonomike dhe politike janë bërë të vështira gjatë katërmbëdhjetë shekujve të fundit. Ndryshime të mëtejshme janë duke ndodhur në një mënyrë të shpejtë. Duke pasur në konsideratë këto ndryshime, si mundet një qeveri e një Republike Islamike t'ia dalë të zbatojë ligje të tilla, që janë hartuar njëmijë e katërqind vite më përpara? A janë ligjet islame (që në ditët e sotme mund të jenë bërë të pazbatueshme) të afta për të zgjidhur problemet e ditëve të sotme?

Mutahhari: Pyetja ka dy aspekte. I pari provon se të gjitha ligjet islame, kriteret, parimet dhe rregullat kanë qëndruar të pandryshuara për njëmijë e katërqind vjet. Dhe aspekti i dytë i pyetjes është po ashtu një provë se situatat njerëzore dhe dinamizmi i tyre janë ndryshuar në mënyrë thelbësore gjatë kësaj kohe. Natyra supozuese e pyetjes e bën atë të vështirë për të vënë në dukje idetë e gabuara përpara se sa të jap një përgjigje të kënaqshme. Pavarësisht nga kjo, një përpjekje duhet bërë.

Nuk ka asnjë fakt që mund të kundërshtojë se koha sjell gjithmonë ndryshim. Por një gjë e rëndësishme është edhe pritshmëria e njerëzve për t'u përshtatur me situatat në ndryshim. Një qenie e vetme njerëzore është si një udhëtar në një karvan dhe shoqëria është vetë karvani që shkon nga një vend në tjetrin. As individi dhe as shoqëria nuk mund të mbeten statike ose të qëndrojnë në të njëjtën gjendje.

Do të ishte kundër ligjeve të natyrës, që një situatë e njëjtë apo një ngjarje e caktuar të përsëritet vazhdimisht.

Për më shumë, ne nuk duhet të injorojmë faktin se kemi të bëjmë me një dallim ndërmjet një vendi që duam të shkojmë dhe mënyrës se si të shkojmë atje. Ose, mënyra dhe/ose qëllimi, apo rrugët se si të shkojmë atje, duhet të jenë po ashtu të sigurta, madje edhe kur zhvillimi i shoqërisë në përgjithësi ka rënë dakord me një gjë të tillë.

Rrjedhimisht, një vend a mbetet i njëjti kur diçka ndryshohet në favor të diçkaje tjetër? A mundet njerëzimi apo shoqëria njerëzore të shkojnë drejt një qëllimi tjetër, le të themi çdo ditë, apo të ndryshojnë drejtim në çdo fazë të zhvillimit?

Të gjitha përgjigjet janë mohuese. Çdo shtrirje e veçantë e evolucionit shoqëror, që është pranuar gjerësisht, në parim mbetet e pandryshuar. Është si një aks ekzistues i planetit, i cili mbetet i pandryshuar, pavarësisht nga ndryshimet që mund të ndodhin rrotull tij, apo nga revolucionet që mund t'u ndodhin orbitave të tjera të këtij planeti në një kohë të caktuar. A është e mundur që një planet, për të qenë sa më dinamik, duhet ta bëjë aksin e tij sa më të lëvizshëm? Ndërkohë, që aksi i tij mbetet i palëvizshëm, a mund t'i shkaktojë kjo planetit një qëndrim të palëvizshëm në orbitë? Është e qartë që përgjigjet janë mohuese.

E njëjta analogji mund të vihet re edhe në rastin e njerëzimit. Në këtë kontekst, pyetja e parë që vjen në mendje është se, nëse fakti i të qenit njerëzor, si dhe vlerat njerëzore janë realitete që mund të shihen si të ndryshueshme. Me fjalë të tjera, a mundet që standardet dhe vlerat njerëzore të ndryshojnë medoemos sipas dinamikave të jetës njerëzore dhe sipas qytetërimeve?

A e humbet vlerën e saj ditën tjetër diçka e proklamuar nga njerëzimi si e dobishme dhe e rëndësishme? A mund të zëvendësohet nga gjëra të tjera me një qasje negative, në krahasim me vlerat e mëparshme normale për standardin njerëzor?

Në mënyrë alternative, a mendoni se për të qenë një Tshombe apo Muavije i ardhshëm është diçka që dikush mund ta vendosë për veten e tij si një standard të pëlqyeshëm, si Lumumba apo Ebu Dherr-i, edhe pse këta ishin në kundërshtim me njerëzimin?

Nëse jo, atëherë ju duhet të argumentoni që secili, që kërkon të bëhet një Ebu Dherr, nuk përfaqëson diçka apo një karakteristikë të një ndarjeje të vazhdueshme nga drejtimi i përgjithshëm i njerëzimit. Kjo është edhe më shumë, sepse është në natyrën e njeriut që kërkon përparim dhe përsosmëri të vlerave njerëzore, të standardeve dhe të kriterëve, në mënyrë të përhershme.

Me virtytin e qëndrueshmërisë dhe natyrën revolucionare të njeriut, njerëzimi ka qenë i aftë të zhvillojë dhe të forcojë vlerat ekzistuese. Këto vlera janë të një rëndësie të veçantë në zhvillimin e shoqërisë. Funkzioni i tyre është i njëjtë me atë të shenjave të vendosura në një tokë pa pemë apo në një shkretëtirë, për të përcaktuar rrugën që duhet ndjekur. Standardet që njerëzimi gjithmonë ka ruajtur dhe ka mirëmbajtur, janë gjithmonë të vlefshme dhe thelbësore për përsosmërinë e gjithanshme të shoqërisë. Nuk ka asnjë arsye për të hequr dorë nga vlerat njerëzore apo për t'i ndryshuar ato.

Në kreun “Islami dhe jeta moderne” të librit tim “*Të drejtat e gruas në Islam*”¹¹, e kam bërë të qartë se si një shoqëri islame mund të zgjidhë problemet e vështira të kohëve moderne dhe të shoqërive të ndryshme. Kam theksuar faktin se a është jeta moderne e shqetësuar me parime të rrënjosura nga koha, për një vazhdimësi natyrore është thelbësisht e bazuar në një tjetër pyetje të rëndësishme filozofike.

Të gjitha konsideratat filozofike të lartpërmendura përfshijnë sa më poshtë:

- Nëse njeriu ka zbuluar ndonjë transformim në veten e tij, goftë edhe së fundmi, ndërkohë që ai merrte pjesë në procesin e zhvillimit.

- A i janë shfaqur njeriut karakteristika të ndryshme në çdo epokë?

- A mundet që bazat thelbësore të jetës njerëzore të ndryshojnë në një tjetër bazë krejtësisht të ndryshme? Nëse kjo është vërtet e rëndësishme, a mundet që të gjitha ligjet e

11. Përkthyer/publikuar nga World Organization for Islamic Services (WOFIS), P.O. Box: 2245, Tehran, Iran.

evolucionit të shoqërisë njerëzore (duke përjashtuar ato që kanë zbatueshmëri të njëjtë si te njerëzit, ashtu edhe te kafshët) mund të zëvendësohen?

- A është natyra njerëzore e ngjashme me ndryshimet e formës së ujit, që udhëhiqet nga një tërësi ligjesh natyrore kur është në fomë të lëngshme dhe nga të tjera ligje kur është duke vluar dhe merr natyrë të gaztë/të avullt?

- Nëse përgjigjet e mësipërme janë mohuese, a nuk do të thotë kjo që përgjatë historisë, natyra e njeriut ka mbetur e njëjta dhe pa asnjë ndryshim thelbësor?

Për ta përmbledhur, nuk do të jetë e pasaktë nëse favorizojmë këndvështrimin (pa shkuar në çështje filozofike) se njeriu ka qëndruar pothuajse i njëjtë përgjatë shekujve, që nga shfaqja e parë mbi tokë dhe ka qenë një faktor i qëndrueshëm në zhvillimin e tij social.

Pavarësisht nga mundësia e çdo variacioni të zakonshëm apo natyror, në procesin e krijimit të njeriut, nuk ka pasur asnjë mutacion të qenieve njerëzore si specie. Për më shumë, nën Ligjin Hyjnor të Krijimit, evoluimi psikologjik, shpirtëror dhe sociologjik i njeriut ka qenë më i dukshëm se sa zhvillimi apo mutacionet e tij trupore.

Në këtë kuptim, natyra e veçantë e njeriut ka mbetur e njëjta, duke specifikuar për të një mënyrë jetese, e karakterizuar në mënyrë të pashmangshme nga një sërë parimesh të sanksionuara nga koha që qeverisin mënyrën e zhvillimit individual përgjatë jetës, përfshin arritjet dhe ndërveprimet sociale përgjatë një tërësie fazash të jetës. Megjithatë, në një shoqëri ku individët janë të detyruar të kenë për vetën e tyre një tërësi qëllimesh, sipas natyrës së tyre, duhet të përcaktojnë se çfarë është e rëndësishme për t'u ndjekur. Veç kësaj, njerëzit janë të detyruar të ndjekin rrugët e jetës që janë të ndryshme nga njëra-tjetra në një nivel individual dhe social.

Në këtë rast, një person mund të dallojë nga qëllimi i ligjeve islame parimet themelore të përpjekjeve njerëzore më tepër se

çfarëdolloj qëllimi jetësor që ndërton bazat e tij. Në të njëjtën kohë, ligjet islame janë të themeluara që të kenë në konsideratë nevojën për të përgatitur njerëz që duan të arrijnë objektiva të njëjtë. Për më shumë, mënyra islame e të jetuarit është e ndryshueshme, në varësi të natyrës dhe përmbajtjes së nevojave njerëzore për qëndrueshmëri dhe përshtatje. Veçantitë e ligjeve islame janë diskutuar në mënyrë shumë të saktë në librin “Të drejtat e gruas në Islam”. Për diskutimin tonë mund të shpjegohet me anë të një shembulli.

Ne duhet të fillojmë ta ilustrojmë përmbajtjen dhe dinamizmin e shoqërisë islame, duke cituar një sure nga Kur’ani i Shenjtë:

وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْخَيْلِ تُرْهَبُونَ بِهِ عَدُوَّ اللَّهِ وَعَدُوَّكُمْ وَآخَرِينَ مِنْ دُونِهِمْ لَا تَعْلَمُونَهُمُ اللَّهُ يَعْلَمُهُمْ وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فِي سَبِيلِ اللَّهِ يُوَفَّ إِلَيْكُمْ وَأَنْتُمْ لَا تُظْلَمُونَ

“Përgatisni kundër tyre forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t’ju shpërblehet dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.” (Kur’an, 8: 60)

Gjithashtu, ne mund të citojmë se jurisprudenca islame dhe tradita e Profetit (s.a.s.), përsa i përket nevojës për të kërkuar përvojë (si në kalërim ose në shigjetim) përmes konkurrencës, si në rastin e ushtrimeve “mëso një mësim” apo “tremb një armik”, ka qenë njohur si diçka e urdhëruar nga Profeti, i cili vetë ka marrë pjesë në gjëra të tilla.

Tani, nëse ekzaminojmë parimet që janë pas *“Përgatisni kundër tyre”* ne do të arrijmë në përfundimin se ka të bëjë me diçka që është e re dhe e vlefshme, e pavarur nga kohërat. Sa herë që urdhri për praktikë thotë që kalërimi/shigjetimi nuk është më e domosdoshme dhe e volitshme, për shkak të ndryshimeve në artin e të luftuarit apo të gjendjes së ushtrisë.

Megjithatë, ndarja e ekspertizës në fushën e ushtrisë është një proces që vazhdon edhe në ditët e sotme. Kjo nevojë është pasqyruar në parimin e sipërpërmendur të Kur'anit. Sipas traditës së Profetit (s.a.s.) ne e trajnojmë ende veten tonë për betejat moderne.

Falë Zotit, një tërësi shembujsh të tjerë tregojnë mundësinë e një marrëdhënieje të ndjeshme me ligjet islame që ekzistojnë. Parimet e pasqyruara në ligjet islame nuk janë të pandryshueshme por lejojnë përshtatje të natyrës dinamike njerëzore dhe në baza të vazhdueshme, pa e cenuar natyrën dhe përmbajtjen e tyre kryesore. Për ta shpjeguar këtë më shumë, është i nevojshëm një tjetër shembull.

Në Kur'anin e Madhërishëm gjendet një parim që drejton cilësinë dhe mënyrën e një jetese të shëndetshme në shoqëritë islame. Kjo është e qartë në vargun kur'anor, të cituar më poshtë:

وَلَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ

“Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht!” (Kur'an, 2:188)

Çfarë u tha më lart nënkupton se çdo transaksion ekonomik ndërmjet njerëzve që nuk ka një qëllim të dobishëm për shoqërinë është i panevojshëm. Pra, transferimi i çdo gjëje ekonomike nënkupton legjitimitet të kërkuar sa te një person te tjetri dhe duhet të jetë në një perspektivë të tillë, që t'i përfshijë të gjitha nevojat e njerëzve në një shoqëri.

Rrjedhimisht, nëse dikush ka mjete ligjore për të kërkuar, le të themi një sasi të madhe milingonash të ngordhura vetëm për t'i hedhur tutje, ky veprim është tërësisht i kotë. Nëse këto milingona të ngordhura përdoren për qëllime të dobishme (ose shkencore), atëherë ky veprim do të ishte i vlefshëm. Kjo lidhje e anasjellë ndërmjet asaj që mbetet e ndaluar “sot” ka qenë e paraparë në Kur'an (për shembull në ajetin 2:188). Nga *muxhthid*-i (autoritet në jurisprudencën islame) pritet që të interpretojë ligjet islame në mënyrë korrekte dhe në bazë të zbatimeve të tyre më të

fundit dhe të miratojë ose jo një veprim të caktuar në kontekstin e ligjeve të Sheriatit.

Një rast tjetër i natyrës së ndryshueshme të veprimeve ka të bëjë me gjakun njerëzor. Çështjet që kishin të bënin me gjakun njerëzor kanë qenë të ndaluara në kohët e shkuara. Tashmë, rëndësia e dhurimit të gjakut për të shpëtuar jetë është përcaktuar dhe rregullat islame që i përkasin kësaj çështjeje janë bërë lejuese, për sa kohë dhurimi i gjakut është i domosdoshëm, si dhe përfshijnë edhe shpërblime monetare për një veprim të tillë.

Shembujt e mësipërm ilustrojnë idenë se përfitimet sociale të para sipas kuptimit dhe ligjeve islame mbeten kriteri më i rëndësishëm për të vlerësuar çdo aktivitet ekonomik apo transaksion. Ky parim nuk është i prekur nga asnjë ndryshim në rregulloret e bëra në kuadër të ligjeve islame, të nevojshme për transformimet në fushën e aplikimeve të tilla, si përdorimi i gjakut të njeriut.

Përputhja ndërmjet parimeve islame të frymëzuara nga Hyjnorja dhe detajet e çështjeve në proces të zbatimeve të tyre, është mbajtur si rezultat i *Ixhtihad*-it (një zbatim funksional i jurisprudencës islame). *Fakih*-u (një *muxhtehid* i aftë për të interpretuar dhe për të drejtuar mbi bazën e jurisprudencës islame) është përgjegjës për të vlerësuar dhe për të përditësuar detajet e rregulloreve të formuluar në të shkuarën, si të rëndësishme për strukturën ligjore islame.

-V-

P se të mos përpiqemi për një sintezë ideologjike ndërmjet Demokracisë dhe Socializmit në njërën anë dhe Islamit në anën tjetër?

Intervistuesi: Ju e keni përshkruar mjaft mirë natyrën hyjnore të ligjeve islame, duke e përcaktuar si rrugën më të përshtatshme për njerëzimin. Ende, në kohët tona, është argumentuar në mënyrë të vazhdueshme se, nëse dy nga arritjet më të mëdha ideologjike të njerëzimit, demokracia dhe socializmi, të marra së bashku dhe të plotësuar me parimet më të rëndësishme islame (për përfitim të myslimanëve në veçanti), do të shtonim një mënyrë vërtet efektive për përmirësimin njerëzor, pa pasur nevojë për ndonjë burim shtesë të frymëzimit hyjnor? A jeni dakord?

Mutahhari: Demokracia dhe socializmi janë të prirura për papajtueshmëri në shumë gjëra. Dallimet e tyre konceptuale lënë ende vend për zgjidhje. Demokracia është, më së shumti, e orientuar drejt individualizmit, pra, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individit. Në të kundërt, socializmi është i bazuar në kolektivizmin dhe precedencën e të drejtave sociale mbi ato individuale. Kjo nënkupton se socializmi i kufizon liritë dhe demokracinë individuale.

Sot, në botë disa vende kërkojnë të ndjekin demokracinë dhe disa të tjera favorizojnë socializmin. Analistët politikë pranojnë se polarizimi i vendeve ndaj demokracisë dhe socializmit, përkatësisht, nuk ka sjellë akoma liri reale në rastin e së parës dhe nuk i ka sjellë praktikatat socialiste në rastin e së dytës.

Nga ana tjetër, grupi i vendeve liberale nuk flet për socializmin. Edhe kur ata thonë se janë edhe demokratike edhe socialiste,

në të vërtetë nuk ka asnjë të dhënë për këtë. Vendet socialiste, gjithashtu, mezi diskutojnë ndonjë çështje demokratike. Edhe ata që ndërmjet tyre e quajnë veten demokratë dhe socialistë, në të vërtetë, nuk bëjnë asgjë me vlerë.

Pyetja nëse duhet të favorizojmë njërin apo tjetrin pol të demokracisë dhe socializmit, apo një kombinim të të dyjave, nëse ato me të vërtetë mund të kombinohen, përfshin jo vetëm një trajtim ligjor, por dhe filozofik. Në të njëjtën kohë, dikush duhet të marrë në konsideratë edhe grupet e përziera në ideologji, të cilat tregojnë lidhje me të dyja, demokracinë dhe socializmin, në kuptim të përpjekjes për të krijuar një sintezë.

Në kontekstin filozofik, problemi i lidhjes së demokracisë dhe socializmit vërtitet rreth fokusit të tyre tek individualizmi dhe te kolektivizmi. Për sjelljen e protagonistëve të demokracisë, në njërën anë dhe të socializmit në anën tjetër dhe të atyre që mbështesin një përzierje të të dyjave, kërkon një përgjigje për të njëjtën çështje ligjore. Çështja qëndron në faktin nëse një individ duhet të njihet si një etnitet ligjor më të drejtat e tij dhe shoqëria si një dukuri aksidentale e një rëndësie dytësore apo formale.

Nëse përgjigjja është pohuese, ata që e pranojnë lehtë një gjë të tillë, duhet, që në mënyrë të natyrshme, të postulojnë që demokracia duhet të ketë përparësi mbi socializmin. Nga ana tjetër, çdo pranim i një përgjigjeje negative është tregues i dogmës se njeriu sociologjik vjen përpara njeriut psikologjik, prandaj individualiteti nuk ka afirmim ligjor. Ata që nuk pranojnë individualitetin njerëzor tentojnë të injorojnë shpirtëroren dhe brendësinë e tyre individuale, po ashtu edhe dëshirën dhe vullnetin e tyre. Ata presin që njerëzit ta bëjnë veten e tyre subjekt të interesit publik dhe të pasqyrojnë shpirtin e tyre kolektiv për disiplinimin e shoqërive të tyre, të cilat ata i trajtojnë si të vetmet entitete njerëzore në termat socialistë.

Ndërkohë, rekursi drejt një tjetër mundësie është gjithashtu i mundshëm. Ai nuk konsiston as në thithjen e individualitetit njerëzor (jo vazhdueshmërinë si trup) në shoqëri dhe asnjë mohim

të shoqërisë si një etnitet real dhe kuptimplotë. Përkundrazi, ai përfaqëson themelet e një marrëdhënieje dypalëshe ndërmjet personalitetit njerëzor dhe shoqërisë së tij, brenda një strukture të përgjithshme filozofike.

Filozofia e lartpërmendur është e njëjtë me filozofinë tonë islame, ku thuhet se uniteti (cilësia) dhe tërësia (sasia) janë gjithëpërfshirëse. Mbase shpjegimet e hollësishme nuk janë të garantuara në diskutimin tonë të tanishëm.

Pyetja juaj bën thirrje për disa shpjegime të hollësishme të asaj çka ne konsiderojmë të jetë *Ma'newijeh* (plotkuptueshmëri apo përmbajtje intelektuale/shpirtërore e diçkaje). Dikush mund të dallojë në pyetjen tuaj nevojën për një strukturë ideologjike për çdo kombinim të demokracisë dhe të socializmit, që disa njerëz besojnë se ata mund të arrijnë.

Si rrjedhim, kërkesa e parë është sigurimi i normave të sjelljes dhe të karakterit më të përshtatshëm njerëzor. A është krijimi i këtij karakteri aq i lehtë sa dhe krijimi i gjelbërimit në një qytet, ku që të përballësh me atmosferën urbane shpesh të papëlqyeshme, investohet kapital dhe punëtorë? Apo kërkohet diçka më shumë, e arritshme, duke përfshirë besimin e përshtatshëm, tendencat dhe botëkuptimin?

Dikush mund të pyesë se çfarë tendencash dhe botëkuptimesh njerëzore janë efektive për të siguruar afri te karakteri përkatës dhe si mundet që këto të përfshihen.

Disa sintetizues të demokrato-socialistëve që mendojnë si të rëndësishme krijimin e një mjedisi intelektual të papëlqyeshëm për të trajtuar *Ma'newijet*-in në një mënyrë sekulare, sikur ata të ishin të ndryshëm nga feja.

Sipas tyre, *Ma'newijet*-i ekziston aty ku janë parë problemet njerëzore në një mënyrë të pabazuar, pa ndonjë diskriminim racial, fetar apo diçka të ngjashme. Ata e konsiderojnë fenë si diskriminuese në kuptimin që trajtimi ligjor i ndjekësve të saj është i ndryshëm nga ai i atyre që nuk janë ndjekës. Ata besojnë se diskriminimi ia ul vlerat intelektuale, shpirtërore apo

psikologjike fesë.

Ata duan të ndërtojnë një botë që lidhet me *Ma'newijet*-in (aspektin shpirtëror), por që largohet nga feja. Shqetësimi i tyre për individualitetin dhe mospëlqimi ndaj fesë janë reminishente për gjithë njerëzimin dhe për ekzistencializmin ateist, siç kumtohet nga Zhan Pol Sartri.

Humanizmi apo ekzistencializmi mund të jenë po aq popullorë, sa edhe motoja që i përbën ata. Me gjithë apelin e tyre të vazhdueshëm për sekularizimin e intelektualëve, ata mbetën të paarritshëm.

Asnjë konceptim sekularist i intelektit njerëzor apo perceptim njerëzor i rastit për të përmirësuar natyrën njerëzore, nuk shfaq ndonjë përpjekje negative. Megjithatë, në praktikën aktuale ata dështojnë në atë çka pretendojnë të bëjnë. Një çështje në fjalë është simpatia e njëanshme e Sartrit për Izraelin.

Të tjerë provojnë të improvizojnë një lloj të ri strukture ideologjike, duke përfshirë demokracinë dhe socializmin dhe po ashtu edhe fenë. Duke e përdorur fenë, ata synojnë të jenë përzgjedhës për sa i përket përmbajtjes së tyre ideologjike dhe botëkuptimit universal. Pastaj ata kërkojnë të rekrutojnë mbështetjen e studiuesve fetarë, veçanërisht të atyre me tendenca mistike.

Edhe nëse do të jetë e mundur të arrihet në një kombinim të demokracisë, socializmit dhe fesë, ky nuk është rasti i Islamit. Islami nuk është i përgjegjshëm për asnjë praktikë sipërfaqësore dhe të paplotë. Çdo gjë e bërë në emër të tij, pa përfshirë në të vërtetë mësimet e tij në të gjitha rrugët e jetës, do të jetë dukshëm në kundërshtim me të. Për më shumë, Islami do të nënvlerësohet, madje do të përpiqen ta shpërbëjnë atë, kështu që jo çdo gjë ka mbetur e njëjtë.

Në përgjigje të pyetjes, nëse do të arrijmë në çfarëdo sinteze të përshtatshme, siç u përmend nga ju, ne mund të marrim në konsideratë disa pikëpamje të Iqbalit, të cilat lidhen me të.¹²

12. Iqbal Lahori: *Ahya-i-Fikre-Deeni dar Islam (Reconstruction of Religious Thought in Islam)*, Ashraf Publ., Lahore, f. 203.

Ai thotë që bota moderne ka nevojë për tri gjëra:

1. një perspektivë shpirtërore të botës;
2. liri individuale ndaj riorientimit shpirtëror; dhe
3. parimet thelbësore të një rëndësie universale, të aftë për të ofruar bazat shpirtërore për të justifikuar evolucionin social të njerëzimit në tërësi.

Kërkesa e parë e përmendur më sipër është e një interpretimi dinamik të botës nën dritën e një perspektive shpirtërore-intelektuale. Mund të kuptohet në termat e një interpretimi kur'anor, e një procesi të vazhdueshëm për të identifikuar botën si një kusht të rastit, thelbi e së cilës është në substancën hyjnore të Zotit dhe eventualisht do të të kthehet tek Ai.

Kërkesa e dytë, që i përket lirive individuale, është e ngjashme me atë që është paraparë në demokraci. Kërkesa e fundit, e përmendur nga Ikbali, është ajo që mund të ndeshet nga një ideologji e një shoqërie, e aftë për të rregulluar rrugët dhe normat e jetesës dhe për të udhëhequr njerëzit drejt një shtegu të njëjtë evolucionit.

Nëkontekstinekërkesave të mësipërme, vetë Ikbali u referohet kushteve që ai vuri re në Europë. Sipas tij, vendet europiane karakterizohen nga demokraci të një lloji të padobishëm, sepse ata vazhdonin të kërkonin interesat kombëtare për të shfrytëzuar pikat e dobëta në shoqëritë e tyre, në mënyrë që të fitonte më i forti. Kjo ishte e pashmangshme në shoqëritë me tipare dalluese individualiste.

Për më shumë, Ikbali vuri në dukje se myslimanët kanë një ideologji jopërfundimtare në vlerë dhe rëndësi dhe të bazuar në shpirtin njerëzor dhe të aftë për t'u përballuar me dinamizmin e jetës, përmes bindjes shpirtërore dhe joegoizmit dhe po ashtu gatishmërisë për të dhënë jetën për një çështje morale.

-VI-

Sa mirë mund të analizohet revolucioni në Iran?

Intervistuesi: Sipas mendimit tuaj, sa mirë mund të analizohet revolucioni në Iran? Ata thonë që revolucioni në Iran është i ndryshëm nga të gjitha revolucionet e tjera në historinë e botës. Cilat janë karakteristikat që e dallojnë? Ju lutem, shpjegoni natyrën islame dhe përmbajtjen e revolucionit në Iran.

Mutahhari: Kuptimi në fjalor i fjalës arabe *inkilab* apo *revolucion* rrotullohet rreth *anasjellë* apo kthimit lart e poshtë, përfshirë çdo përmbysje të një qeverie, sistemi social apo një modeli, ndër të tjerë të ngjashëm.

Kur'an i Madhërishëm përdor fjalët *inkila* dhe degëzimet në kuptimin e saj të vërtetë dhe jo në ndonjë kuptim figurativ apo idiomatik, siç është vënë re në përdorimin e tanishëm. Degëzimet e përfshira në Kur'an janë: *taklib* - transformim/ anasjellësi dhe *munkalib* që tregon *përmbysje*. Një tjetër degëzim, *jenkalib* përmendet në fragmentin kur'anor, të cituar më poshtë:

وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ أَفَإِنْ مَاتَ أَوْ قُتِلَ انْقَلَبْتُمْ عَلَىٰ أَعْقَابِكُمْ وَمَنْ يَنْقَلِبْ عَلَىٰ عَقْبَيْهِ فَلَنْ يَضُرَّ اللَّهَ شَيْئًا وَسَيَجْزِي اللَّهُ الشَّاكِرِينَ

“Muhamedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahu. Dhe Allahu do t'i shpërblejë falënderuesit.” (Kur'an, 3:144)

Vargjet e mësipërme, të shkruara gjatë Betejës së Uhudit, pasi u përhap fjala se Profeti (s.a.s.) ishte vrarë si pasojë e një

tërheqjeje kaotike të një numri të konsiderueshëm luftëtarësh myslimanë. Paralajmërimi hyjnor theksoi se profeti Muhamed (s.a.s.) ishte një lajmëtar i Zotit si dhe shumë të tjerë para tij. Si rrjedhim, ai, si dhe shumë profetë të tjerë, do të ishte një vdekatar dhe madje edhe mund të vritej. Ajo çka mbeti e pavdekshme është Mesazhi Hyjnor që ishte caktuar për t'u zbatuar.

Kështu që, në rast të vdekjes natyrore të Profetit apo vrasjes së tij, a do t'i ktheheshin myslimanët çfarëdolloj idhujtarie që ata kishin praktikuar para Islamit? Në terminologjinë e Kur'anit, fjala *inkilab* është përdorur në kuptimin për të kthyer statusin e mëparshëm pagan të myslimanët e dobët dhe për të treguar se një kthim i tillë ishte me të vërtetë i padëshirueshëm.

Në të kundërt, e njëjta fjalë me kuptimin *kthim* është përdorur si një akt i dëshirueshëm në vargun e mëposhtëm:

فَانْقَلَبُوا بِنِعْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ وَفَضْلٍ لَّمْ يَمَسَّ لَهُمْ سُوءٌ وَاتَّبَعُوا رِضْوَانَ اللَّهِ وَاللَّهُ ذُو فَضْلٍ عَظِيمٍ

“Ata u kthyen me dhuntitë dhe mirësitë e Allahut, nuk i gjeti asgjë e keqe dhe fituan kënaqësinë e Allahut. Allahu është zotërues i mirësive të mëdha” (Kur'an, 3:174)

Në shembullin e parë nga Kur'ani, fjala *inkilab* është përdorur me të njëjtin kuptim si në të dytin. Megjithatë, konteksti përkatës i tyre ishte i ndryshëm. Në kontekstin e parë, *kthim* ishte me kuptimin retrospektiv (d.m.th., rikthimi në idhujtari, në rrugën e së shkuarës). Në kontekstin e mëvonshëm, e njëjta fjalë nënkuptonte kthimin në gjendjen e mëparshme të besimit absolut në Zot (pasi u identifikua paniku në Betejën e Uhudit)

Shembujt e mësipërm nga Kur'ani e bëjnë të qartë se nuk është asgjë e shenjtë apo e pafé, për sa i përket kuptimit të veçantë të fjalës. Kuptime të tjera idiomatike i bashkëngjiten fjalës përgjatë shekujve dhe periudhave të mëvonshme dhe si rrjedhojë e punëve filozofike. Megjithatë, interpretimi fillon të ndryshojë.

Për shembull, në një pjesë të jurisprudencës islame ne përdorim të njëjtën fjalë d.m.th., *inkilab -revolucion*. Sipas

interpretimit të parë, fjala është përdorur si sinonim për *istihaleh* apo transformim (si në rastin e një shkopi të djegur, që hiri i tij trajtohet sa më mirë të jetë e mundur, për ta përdorur atë për pastrim në rastin e mungesës së ujit.)

Në kontekstin filozofik, fjala *inkilab* nënkupton transformimin e gjërave, të cilat përbëjnë domosdoshmërisht ndryshime në natyrën dhe në përmbajtjen e tyre. Gjithashtu, kemi të bëjmë me çështjen nëse ndryshimet e një revolucioni janë në të vërtetë të mundura apo jo. Disa mund të thonë se nuk është e mundur, për shkak të natyrës së gjërave, për të cilat ata besojnë se janë të pandryshueshme. Të tjerë që përkrahin teorinë që gjërat fillimisht ekzistojnë në një formë që mund të ndryshohet në një tjetër, besojnë jo vetëm në revolucion, por edhe në ndryshimet revolucionare, qoftë edhe të një rëndësie të vogël, por që shkon drejt përsosmërisë.

Në përdorimin e tanishëm, fjala është përshkruese e një kuptimi të veçantë, në një kontekst socio-politik dhe historik. Sinonimi më i vonshëm i *inkilab* është *thewra* në arabisht apo *revolucion* në disa gjuhë të tjera europiane. Në kontekstin sociologjik nënkupton një ndryshim relativ më tepër se sa një ndryshim absolut. Nuk nënkupton ndonjë transformim të gjërave në diçka tërësisht tjetër. Më fjalë të tjera, vë në dukje zëvendësimin e një realiteti me ekzistencën e një realiteti krejtësisht tjetër.

Kuptimi i mësipërm dhe rëndësia e ndryshimeve të revolucionit, siç është kuptuar deri tani, është e sjellë shumë qartë në lidhje me Kur'anin dhe në të njëjtën kohë dhe me poemat e Ikbalit:

*Ndikimi universal si ai i Kur'anit që ti sheh
eklipsoi projektin papnor dhe planin hebre.
Lërmë të flas nga impulse të simes zemër,
nuk është vetëm një libër, është diçka tjetër
sapo krijon te njeriu një të thellë sens,
ia transformon atij zemrën dhe të tijin univërs.*

Llojet e ndryshimeve revolucionare, të cilave u jemi referuar më lart janë të treguara edhe në këto vargje. Ikbali thotë që Kur'ani është i aftë për të përçuar te njeriu një shpirt revolucionar, që çon në një ndryshim të rëndësishëm të perceptimit njerëzor për universin e jashtëm.

Çfarë u tha më sipër e bën të qartë që fjala *inkilab* mund të ketë kuptime dhe konotacione të shumta. Këto përfshijnë një “ndryshim relativ” në kuptimin e evoluimit sociologjik të njeriut në perspektivën historike dhe një “ndryshim jetësor” në kontekstin filozofik. Nuancat më të shumta të fjalës janë të përmbledhura më së shumti këtu, së bashku me faktorët dhe motivacionet që ndikojnë kuptueshmërinë e tyre në perspektiva të ndryshme. Pastaj ne mund të kalojmë te karakteristikat thelbësore të revolucionit.

Nganjëherë, një ndryshim revolucionar ndodh edhe te disa individë. Ky tip revolucioni është i orientuar tek vetë individi, qoftë në natyrën e tij njerëzore apo kafshërore. Kur ne vëmë re se një individ është pak a shumë i fiksuar me një çështje apo objektiv, pa i kushtuar rëndësi asgjëje tjetër, çdo “ndryshim” që ai mund të ketë bërë për të theksuar prirjet e tij për të qenë ambicioz dhe sensual. Mund të jetë një ndryshim revolucionar edhe kur orientohet drejt natyrës kafshërore të tij.

Historia tradicionale e Amir Khaxhandi-t ilustron më së miri fiksimin për ndryshim te njeriu. Sipas kësaj historie, kur u pyet se si e ndryshoi statusin e tij nga një i punëtor i varfër që ngiste një gomar në një pronar të madh pallatesh, Amir Khaxhandi u përgjigj se ndryshimet kishin ardhur si rezultat i përpjekjeve të tij të mëdha për të grumbulluar pasuri ose për t'i dhënë fund jetës. Një ide e tillë është vënë në dukje edhe në vargjet e mësipërme. Ky shembull paraqet një lloj revolucioni në jetën e një individi.

Një tjetër shembull i revolucionit individual mund të jetë ai që përfshin emocionin e dashurisë, veçanërisht të asaj obsesive. Në veprat filozofike të Ebu Ali Sina-s (Avicenës) dhe të Mulla Sadrait është diskutuar natyra e dashurisë. Aty ne mund të gjejmë

konsensus në natyrën revolucionare dhe ndikimin e dashurisë ndërmjet individëve. Një tjetër lloj revolucioni në jetët e njerëzve është prezantuar nga *teube*-ja apo betimi i rëndësishëm për të mos vazhduar të përsërisësh diçka të keqe dhe të padëshirueshme.

Teube-ja (pendimi) thekson revolucionin që ne bëjmë kundër vetes sonë. Është një revolucion psikologjik, filozofik, sociologjik dhe me një kuptim të rëndësishëm për njeriun. Është ajo çka arrihet nga një person i nënshtruar ndaj forcës që e ka nënshtruar atë. Në këtë rast, njeriu fiton vlera edhe më të mëdha nga çfarë është i aftë të fitojë. Një revolucion që njeriu e bën për veten e tij është pozitiv, kur sjell humanizëm në vend të veprimeve që përcjellin ndjesi kafshërore.

Me fjalë të tjera, një individ arrin një shkallë në zhvillimin e tij personal, kur ai bën një kapërcim të veseve të tij. Ai i kërkon të drejtat e tij, duke u nisur nga vetja. Ai “ndëshkon” veten. Ai betohet se kurrë nuk do të lejojë që sensualiteti i tij të mbizotërojë mbi ndjeshmërinë e tij.

Teube-ja, e shpjeguar më sipër, është një individ plotësues i revolucionit të shoqërisë me drejtësi dhe ndershmëri. Ashtu siç një njeri mund të ndryshojë veten e tij, një shoqëri apo një shumicë njerëzish, mund që në mënyrë efektive ta ndryshojnë një çështje, që shpesh ndikohet edhe një minoritet i vogël, i cili mund të shkojë deri në zvetënimin dhe shkatërrimin e integritetit social. Shumica që i kundërvihet minoritetit, duke i ndëshkuar ata për veprimet e kryera ngjan me një *teube*, që vepron në anën negative.

Shkurtimisht, *teube*-ja¹³ nuk personifikon vetëm reagimin

13. Një herë, Hazreti Aliu (a.s.) ia shpjegoi ndërlikimet e *teube*-s një ndjekësi, i cili po ndiqte një rit tradicional për pendesë, duke menduar se ai po vepronte në një mënyrë të drejtë dhe po e çonte veten e tij në një gjendje të pastër. Emiru’l-Mu’minin e këshilloi dhe e pyeti atë nëse ai i kishte ndier emocionet e *istighfar*-it (të kërkuarit ndjesë) apo nëse ai duhej ta falte vetë veten e tij. Secili duhet të jetë shumë i motivuar në vetvete, në mënyrë që të arrijë të marrë faljen e Zotit në *teube*. Dhe akti i *teube*-s, në vetvete, udhëhiqet nga disa kushte, përfshirë të mëposhtmet:

- Individu duhet të jetë tërësisht dhe sinqerisht i penduar për veprimet e pahijshme që ka bërë në të shkuarën dhe të jetë tërësisht i vetëdijshëm se një veprim të tillë nuk do ta përsërisë më.

njerëzor ndaj çdo lloj zhvillimi trupor, por edhe dëshirat dhe fuqinë individuale të secilit. Është karakteristike për njerëzimin, përderisa është diçka që nuk ekziston te kafshët.

Shembujt e përmendur më sipër flisnin për “revolucionet” që individët shkaktojnë në vetvete; revolucione në nivelin shoqëror, gjithashtu, por të një lloji tjetër. Ndër këta të fundit, ne mund të përmendim Revolucionin Industrial, që filloi në Mbretërinë e Bashkuar tre shekuj më parë. Për më shumë, revolucionet edukative, kulturore dhe shkencore janë pjesë e revolucioneve sociale.

Në Iran, Lëvizja Kushtetuese dhe Lëvizja Islame aktuale përfaqësojnë revolucionet e orientuara nga shoqëria. Shembujt të ngjashëm mund të gjenden edhe në vende të tjera. Lëvizjet sociale bëhen revolucione pasi përmbushin misionin e tyre.

- Duhet të jetë i vendosur për të mos e përsëritur më veprimin e kryer.
- Duhet të kompensojë personat që kanë vuajtur nga veprimet e tij të padrejta, duke vënë në vend të drejtat e tyre, duke paguar detyrimet dhe duke marrë përsipër çdo lloj tjetër përgjegjësie, që lidhet me veprimet e tij të mëparshme.

- Të bëjë mirë në emër të Zotit dhe të mos e harrojë Atë.
- Kushti i shpeshharruar nga pendimtarët është si vijon: “Shih se çfarë ndien në të vërtetë pasi ta kesh ndëshkuar veten për veprimet e këqija që ke bërë, për të cilat je penduar, në mënyrë që ‘dhjami’ që padrejtësisht ke vendosur duke shkelur mbi të mirën e vetvetes dhe mbi nëpërkëmbjen e të drejtave të të tjerëve, duhet të shlyhet me abstenim dhe të qënit i ashpër me vetveten.”

- “Ti mbase ke filluar t’i pëlqesh veprimet e tua të gabuara dhe fyerjet që bën ndaj të tjerëve dhe një gjë e tillë të është bërë zakon. Për të mënjeluar çdo tendencë për të përvetësuar ndjesi negative, ti duhet të përpiqesh ta bësh veten të ndiejë e të përjetojë pendesë e keqardhje të çiltër, si dhe të reflektosh të njëjtat në shërbimet e theksuara dhe veprimet zhdëmtuese ndaj të tjerëve. Vetëm atëherë do të jesh i aftë të pendohesh me të vërtetë dhe të kuptosh se në të shkuarën ke vepruar realisht gabim.”

Në Kur’an fjala *ta’ib* do të thotë *kthim* dhe, kur është në kuptimin pozitiv, shoqërohet gjithmonë nga një fjalë tjetër *aflah* (i/e/të shpëtuar). Fjala e parë mbulon vendimet e njeriut për një veprim negativ. E dyta përfshin një sjellje pozitive dhe të shëndetshme, që shlyen fajet e së shkuarës. Çdo pendim i pranuar është fillimi i një procesi që përfshin riformimin e një revolucioni të brendshëm e të vazhdueshëm. *Teube*-ja është, padyshim, një proces rindërtimi, i ndërmarrë në mirëbesim.

Për më shumë, në gjuhën arabe, fjala *inkilab*, në formën e saj foljore është folje jokalimtare apo pa një objekt të drejtpërdrejtë. Ajo nënkupton një veprim që vetëpërbushet. Kështu është kuptuar në kontekstin e saj idiomatik dhe filozofik, po ashtu edhe në jurisprudencën islame. Megjithatë, kur përdoret idiomatikisht në gjuhën perse, fjala merr një domethënie kalimtare. Për shembull, ne e vendosim atë (më saktë: subjektivisht) në persisht *inkilab kerd* (të bërit revolucion) si të ishte e nevojshme për të shtuar një element të duhur në akt.

Së dyti, ne nuk quajmë revolucion çdo ndryshim shoqëror (apo individual). Në fakt, askush nuk do ta quante revolucion kthimin drejt së keqes. Pra, fjala është përdorur gjithmonë në sensin pozitiv, për një ndryshim revolucionar për mirë, në procesin e vazhdueshëm të zhvillimit shoqëror.

Së treti, kemi edhe një aspekt negativ, ai i refuzimit (le të themi: të një regjimi ekzistues) në kuptimin sociologjik të fjalës.

Që të tria pikat e përmendura më sipër janë marrë në konsideratë për të shpjeguar kuptimin social të fjalës *inkilab*, sipas përdorimit të saj në gjuhën perse, veçanërisht si një revolucion për të mirën e shoqërisë dhe për një rend sa më të mirë shoqëror. Rrjedhimisht, është e pranueshme që një revolucion social mund edhe të nënkuptojë se gjendja mund të marrë për keq para se sa të përmirësohet.¹⁴

14. Sapo të kuptohet qartë koncepti i revolucionit, nuk do të jetë e vështirë të lidhet me Islamin. Islami përfaqëson një aspekt të brendshëm të revolucionit, një revolucion që zhvillohet në një shoqëri apo individ nga brenda. Revolucion i shoqëror, nga njëra anë, është tregues i manifestimeve dhe i ndryshimit islam. Ne të gjithë e dimë se Islami është një fe monoteiste dhe se i lutemi vetëm një Zot. Uniteti Hyjnor është i pasqyruar nga një ymet islam (shoqëri islame), ku individët e identifikojnë veten e tyre me vëllezërit e tyre myslimanë; ndërkohë, shoqëria, si një e tërë, identifikohet nga individi. Pa hyrë në detaje, për sa u përket ndërlikimeve teorike dhe praktike të *Tehuid*-it (Unitetit Hyjnor), ai do të jetë i mjaftueshëm për të vënë në dukje se bazat e konceptit nuk lënë hapësirë për dualizëm apo besim politeist. Në të vërtetë, *Teuhidi* gjithmonë urdhëron heqjen dorë nga çdolloj paralelizmi që mund t'i bëhet besimit në Zot. Mbi të gjitha, nënkupton një revolucion që sjell kapërcimin nga besimi i rremë dhe devocioni ndaj hyjnive të rreme dhe e ripohon Unitetin Hyjnor, siç

Sipas revolucionit social, një pyetje e rëndësishme mund të jetë nëse këto janë të njëjtë në formë dhe në substancë. Shkurtimisht, mund të përmendet që në opinionin e disave çdo pabarazi ekonomike në shoqëri mund të çojë në polarizimin e dy klasave, “atyre që kanë” dhe “atyre që nuk kanë”. Çekuilibri socio-ekonomik u atribuohet natyrës së shfrytëzimit të të mirave dhe produkteve dhe zgjatjes së përqendrimit të modelit të shpërndarjes.

Kjo pikëpamje e mbështetur në ndarjet sociale dhe që rezulton nga ndasitë ekonomike, përfshin supozime hipotetike. Ajo nënkupton ekzistencën e një mekanizmi rregullues, që bashkërendon funksionimin përtej fushave ekonomike. Ky funksion përfshin fusha të ndryshme sociale, përfshirë filozofinë, letërsinë, drejtësinë, religjionin dhe të tjera të ngjashme. Ata që besojnë në këtë trajtim, theksojnë ngjashmëritë thelbësore të përpjekjeve në fusha të ndryshme të jetës dhe kjo vetëm për shkak të prirjeve të përbashkëta për të qenë egocentrikë.

Në analizat përfundimtare, çdo shoqëri ekonomikisht e polarizuar, siç përshkruhet më lart, nuk është e gatshme për t’u zhvilluar në baza të vazhdueshme, për të qenë paqësore me thithjen e kulturave dhe të zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore, të bazuara në një ndërgjegje filozofike dhe fetare, dhe për këtë arsye, edhe në një konsideratë të pastër artistike.

Një qasje tjetër është përcaktuar nga ata që ua atribuojnë edhe përmendet në këto ajete të Kur’anit:

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِن بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ لَا انْفِصَامَ لَهَا وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon idhujt (dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.” (Kuran, 2:256)

Rrjedhimisht besimi absolut në Zot nënkupton heqjen dorë dhe mohimin e çdo lloji tjetër besimi paralel apo adhurim të hyjnive të rreme. Heqja dorë duhet të jetë absolute, ashtu si dhe mohorja “la” (jo, nuk, s’). Refuzimi i kufrit, domethënë i blasfemisë apo mosbesimit, i referohet çdo gjëje apo çdo koncepti që çon në mohim të unitetit të Zotit. Kështu që dikush nuk mund të jetë i besimit islam, nëse nuk zbaton *Teuhid*-in.

revolucionet sociale faktorëve përtej çdo polarizimi ekonomik, siç është ndërmjet “atyre që kanë” dhe “atyre që nuk kanë”. Ata mendojnë se ekzistenca e “atyre që nuk kanë”, nuk është e dobishme në shkaktimin e revolucionit.

Sipas shkollave të mësipërme të mendimit, rrënjët që shkaktojnë revolucionet sociale nuk gjenden as në shoqëri, as në ndërveprimin e anëtarëve të saj. Përkundrazi, këto i janë atribuuar direkt natyrës bipolare të temperamentit të njerëzve, që shoqëria e tyre pasqyron.

Për më shumë, çdo ekzistencë e efekteve kontradiktore dhe e ndërveprimeve njerëzore nuk është konsideruar e pakëndshme në mënyrë absolute. Më fjalë të tjera, efektet grumbulluese nuk janë kaq parandaluese, sa të vështirësojnë progresin e përgjithshëm të shoqërisë.

Rrjedhimisht, një shoqëri mund të arrijë progres socio-kulturor edhe përpara se të arrijë pikën më të lartë të zhvillimeve ekonomike dhe teknologjike. Aspektet kulturore të një revolucioni mund të jenë larg nga arritja e vlerave historike, filozofike, morale dhe fetare.

Në të njëjtën kohë, mund të pasqyrojnë statusin mjedisor dhe formimin kulturor të njerëzve, si dhe karakterin e tyre.

Përsa i përket karakterit, është e dukshme se çdo orientim ekonomik dhe teknologjik i zhvillimit të shoqërisë mund të përfshijë vonesë kulturore. Kjo ndodh për shkak të përqendrimit të popullit në përmirësimin e dijes dhe të aftësive teknike. Botëkuptimi i njerëzve është mbizotëruar nga një shqetësim i përgjithshëm për të mira materiale dhe ekonomike të progresit të tyre egocentrik, gjë që mund të krahasohet me *Beenish Abzari* - karakter i orientuar drejt të mirave materiale.

Nga ana tjetër, një rritje e krahasueshme ekonomiko-sociale dhe kulturore gjen mbrojtje nga karakteri i quajtur *Beenish Fitri* - një botëkuptim i krahasueshëm me natyralitetin e gjërave. Karakterizohet nga elementet e mëposhtme:

- Zhvillimi psikologjik i njeriut është më i rëndësishëm se

sa kushtëzimet sociologjike dhe mjedisore.

- Polarizimi i sjelljes njerëzore mund të ketë pasoja sociale.
- Vullneti i lirë i njerëzve dhe liria në zgjedhje janë të prirura për ekzagjerim në praktikën e përditshme.

- Ndërveprimi i lirë social është një karakteristikë thelbësore e *Beenish Fitri*-t. Kjo nënkupton se askush nuk mund të ketë një pikëpamje absolute kundrejt të tjerëve. Prandaj, e drejta për të pasur opinionin tënd duhet të mbështetet. Rrjedhimisht, ajo çfarë duket progresive për disa, për të tjerë është regresive.

Një arsye për vlerësimet dhe interpretimet e mësipërme të progresit të shoqërisë shkon drejt një interpretimi subjektiv të vlerësuesit apo përkthyesit. Shpesh njerëzit pushtohen nga egocentrizmi i tyre, pavarësisht se si shihen apo si perceptohen të mirat e tyre materiale. Në këtë proces, ata domosdoshmërisht u japin përparësi atyre gjërave që duhet të arrijnë. Duke vepruar kështu, ata nënçmojnë, madje mënjanojnë nevojat e tjera, përfshirë këtu edhe disa të domosdoshme.¹⁵

Një çështje e rëndësishme është popullariteti i progresit shkencor dhe teknologjik. Janë bërë përpjekjet për të përfituar edhe nga çdo copëz e burimeve natyrore. Kjo përfshin gjithashtu shqetësimin më të vogël për çdo kërkesë jomaterialiste të njerëzimit, ndërkohë postulon ankesa materialiste dhe lakmuese. Kur shqetësimet materialiste bëhen mbizotëruese në shoqëri, fillon rënia e parimeve morale, që rezulton në rënien psikologjike të njerëzve të prekur. Pastaj lindin edhe mjaft kontradikta socio-ekonomike ndërmjet sjelljeve materialiste dhe jomaterialiste.

Konkretisht, bota materialiste do të shkonte drejt një kolapsi total. Një prognozë e tillë nuk është e vështirë për t'u kuptuar nga secili prej nesh.

- Sjellja dypolare e njeriut pasqyrohet në vullnetin e lirë të

15. Për një shpjegim më të hollësishëm, shih shënimin e Mutahhari-t në fund të faqes (f. 43-44, vëllimi I) në librin e Allama S.M.H. Tabatabai: *Usul-e Felsefe ve Revesh Realizm (Principles of Philosophy and Methodology of Realism)*, Botimet "Sadra", Teheran.

njeriut dhe kjo rezulton në nivele të ndryshme të çdo realizimi ndërmjet individëve. Ndikimi grumbullues dypolar i individëve kristalizohet në dypolaritetin e shoqërisë së tyre. Kështu që njëri pol shoqëror përfaqëson efektet grumbulluese të besimeve të njerëzve të tij dhe të moralit, si dhe manifestimin e nevojave të tyre. Këto efekte përfaqësojnë shqetësimet intelektuale dhe shpirtërore të njerëzve, që japin shkas për zhvillim përgjatë historisë njerëzore.

- Sipas *Beenish Fitri*-t, termat e referencës së zhvillimit njerëzor përfshijnë lirinë, pavarësinë, vetëbesimin dhe mundësinë, për të tejkaluar problemet mjedisore me çdo mënyrë të mundshme.

- Ndryshime të rëndësishme në kursin e historisë së zhvillimit njerëzor kanë qenë më shumë në drejtim të së vërtetës, afirmimit të besimit të njerëzve dhe po ashtu edhe liberalizimit nga mbizotërimi i forcave të jashtme, përfshirë ato natyrore apo psikologjike, si dhe nga faktorët negativë të mjedisit social dhe material.

Shkurtimisht *Beenish Fitri* rrotullohet rreth këtyre çështjeve:

- Kënaqësia njerëzore në kërkim të gjërave kuptimplota për shpirtin e tyre.

- Vlerat njerëzore kanë mbetur gjithmonë të njëjtat, ashtu si në perspektivën e tyre filozofike fillestare dhe nuk janë thellësisht të lidhura me natyrën njerëzore, por vazhdojnë të ndikojnë te ndryshimet relevante dhe te ndodhitë me rëndësi historike.

- Njeriu, si individ, është vazhdimisht i angazhuar në zgjidhjen e konflikteve që dalin para tij, nga natyra dypolare e tij (*njeri vs. kafshë*). Për më shumë, qeniet njerëzore kërkojnë që ta rrisin dalëngadalë humanizimin e tyre në një mënyrë sa më natyrore.

Në shembujt e dhënë është qartësuar se një kërkesë e drejtë e zhvillimit njerëzor është pavarësia shoqërore. Një pavarësi shoqërore është një ndër konstatimet e natyrës së jashtme, e nevojshme për të kaluar sa më shumë pengesa natyrore dhe të

bëra nga njeriu. Pavarësia personale është përcaktuar të jetë mbizotërimi ndaj instinkteve tona kafshërore.

Njeriu fiton pavarësi nga veprimet e tij të gabuara, duke u vetëkontrolluar. Vetëkontrolli është i nevojshëm, në mënyrë që humanizmi të mund të mbisundojë mbi kafshëroren. Kjo vjen nga konsideratat që ne kemi për t'u vetëzhvilluar. Psikologjia individuale ka fuqinë për të kontrolluar dhe për të udhëhequr instinktet psikologjike të gjithsecilit, si dhe mirënjohjen. Rrjedhimisht, njeriu i vetëkontrolluar është më i aftë nga ana psikologjike se sa njeriu i kushtëzuar nga faktorët socialë.

Në kontekstin e mësipërm vihet re se njeriu nuk është i ndikueshëm në asnjë mënyrë mekanike, si rasti i një kasete boshe. Në të njëjtën kohë, ai nuk është i "shfrytëzueshëm" si materialet inorganike që mund të gjejnë përdorim për gjëra të ndryshme. Ai është dinamik, si një bimë e re që ka fuqinë për t'u bërë një pemë frytdhënëse. Dinamizmi i tij natyror, më shumë se sa çdo aftësi mekanike, është instrument në arritjet e lirisë dhe të vetëqëndrimit në një mënyrë graduale.

Intelekti, shpirti apo cilësitë e përkohshme të njeriut shfaqen dalëngadalë përgjatë zhvillimit të tij. Procesi është i ngjashëm me atë të rritjes organike në natyrë. Për më shumë, zhvillimi historik i njeriut, në nivelin shoqëror, varet nga ndikimi i kushteve sociale të zhvillimit individual nga njëra anë dhe të gjithë zhvillimit të shoqërisë, nga ana tjetër, që duhet të sjellë ndjeshmëri në mjedisin fizik të tjetrit.

Temperamenti natyror i njeriut dhe zhvillimi historik nuk janë domosdoshmërisht të kushtëzuara nga nevojat e tij materiale. Disa konsiderata abstrakte janë gjithashtu të përfshira. As në perspektivat natyrore, as në ato historike, njeriu nuk mund të trajtohet sikur të ishte një kafshë e thjeshtë sociale me një vlerë ekonomike.

Për më shumë, siç është përmendur më sipër, njeriu ka natyrë dypolare dhe, si i tillë, është i aftë për t'u tërhequr drejt vlerave të tjera njerëzore, pozitive apo edhe negative. Në të njëjtën kohë,

ky dualitet i natyrës njerëzore nuk i vetënegativizon tendencat e përgjithshme njerëzore përgjatë kërkimit të lirisë dhe ndikimit negativ, që ata mund të kenë te secili dhe kështu të drejtohen drejt përsosmërisë, që dikush është i aftë ta arrijë.

Qartësisht, revolucioni në histori nuk mund të rezultonte vetëm nga paqëndrueshmëria e sjelljeve njerëzore që prekin një shoqëri. Ato i kanë rrënjët e tyre në thellësi të njeriut. Konfliktet e brendshme që prekin individin janë përçuese të zhvillimit të *modus vivendi*-t, që pasqyrojnë shqetësimin e tyre natyror për përsosmëri dhe liri. Kështu që disa trajtime të qenieve njerëzore mund të mbizotërojnë mbi ato negativet, siç bëhet e dukshme edhe në sjelljen e natyrshme të njeriut.

Duke pasur parasysh se kërkesat individuale mund të jenë në përputhje me natyrën, mund të provohet se revolucionet janë të motivuara nga natyra e brendshme e njeriut më shumë se sa nga reagimi ndaj dështimeve të shoqërisë.

Me fjalë të tjera, revolucionet vijnë nga motivimet psikologjike të njerëzve. Konfliktet e brendshme të personalitetit të individëve përpiqen të zgjidhen vetë, për të eliminuar apo për të përmirësuar disa shtrëngime të një rëndësie praktike në jetë. Kështu që për të arritur përmirësim të situatës në nivelin individual dhe social duhet të ndërmerret një proces grumbullues për të realizuar një përsosmëri të tillë, me sa më tepër natyrshmëri me aftësitë njerëzore.

Në të njëjtën kohë, njerëzit ndeshen me diferencat ndërindividuale dhe ndërgrupore, konfliktet dhe vështirësitë praktike. Kjo vjen si rezultat i polarizimit që shfaqet në nivelet individuale dhe sociale, si dhe ndërmjet atyre që shfaqin jo vetëm vlerat e tyre shpirtërore dhe intelektuale, por edhe ndërveprimin social, duke u mbledhur në promovimin dhe në nxjerrjen jashtë të dëshirave që vijnë nga instinktet e tyre kafshërore dhe motivimet.

Konfliktet e sipërpërmendura përfshijnë moralin e njerëzve. Në të vërtetë, mund të interpretohen si një antagonizëm ndërmjet cilësive njerëzore të drejta dhe natyrës që përtërihet

dhe oportunitizmit fals dhe të padrejtë. Shkurtime, këto janë konfliktet ndërmjet asaj çka është e drejtë (*hakk*) dhe asaj që është dukshëm e gabuar (*batil*), siç theksohet edhe në Kur'an.

Sa u tha më sipër, e bën të qartë se konfliktet që rrjedhin nga subjektiviteti i individëve dhe objektiviteti i shoqërive mund të vijnë për arsye të ndryshme. Këto konflikte mund të mos vijnë nga ndarjet e thjeshta klasore apo dallime të tjera ekonomike dhe elemente materiale. Këto mund të mos jenë krejtësisht të bazuara në konsiderata politike. Këto duhet të jenë gjithmonë për arsye të vlefshme.

Të tjera arsye mund të jenë përpjekjet pozitive intelektuale apo drejtimit negative materialiste të njerëzve. Intelekti pozitiv përfshin besimin dhe frymëzimin. Ai, po ashtu, pasqyron një sens universal njerëzor të mirëpërcaktuar. Gjithashtu, projekton një ndërgjegje kuptimplotë dhe dinamike për të mirën e krijesave të tjera. Në të njëjtën kohë, është harmonik me nevojat e veçanta të krijimit dhe me mirëqenien, të ndërtuar sipas kërkesave natyrore.

Drejtimi negativ i çon njerëzit në keqkuptime të botës materiale dhe fizike. Mendimet dhe veprimet e tyre janë të motivuara më shumë nga fizikja se sa nga intelektu njerëzor. Kafshërorja përcakton përpjekjet e tyre individuale dhe kolektive. Ata pasqyrojnë jo vetëm sensualitetin, por edhe ndërveprimet e bazuara në konsideratat e *quid pro quo*, vetinteres të ndërsjellë.

Drejtimi i mendimeve materialiste apo *Beenish Abzari* mund të shprehet në mënyrë të përmbledhur me pikat e mëposhtme:

- Të bërit e të varfërve ekonomikisht dhe të dobtëve kulturalisht (*musted'afin* - të shtypur) që t'u shërbejnë interesave materialiste të politikëbërësve.

- Qëllimet e tyre puqen në lirinë nga detyrimet materiale, pra, të mira materiale, duke siguruar përfitime dhe avantazhe.

- Qëllimi i tyre më i rëndësishëm është zhvillimi i mjeteve të prodhimit.

- Korniza e tyre teorike injoron nevojat njerëzore që janë të vazhdueshme dhe e drejton vëmendjen e tyre vetëm drejt

fitimeve materialiste me të gjitha mjetet e nevojshme.

- *Modus operandi* i tyre tenton të çrregullojë *status quo*-në legale të një situate të dhënë apo të rregulloreve autoritare në proces të ruajtjes së interesave materiale.

Përkundrazi, drejtimi i mendimeve natyrore të *Beenish Fitrit* nuk karakterizohet nga elementet e mëposhtme:

- Të konsideruarit e të shtypurve (*musted'afin*) si zbatues dhe jo si politikëbërës.

- Trajtimin e gjërave si të fundme në vetvete.

- Nuk i kushtojnë shumë rëndësi mjeteve të prodhimit.

- Predikimi i metodologjisë së veprimeve në përshtjellim me lidhjen ndërmjet parimeve bazë (përfshirë nevojën për zhvillimin e mjeteve të prodhimit) dhe zhvillimin tradicional të ligjeve dhe kritereve.

- Postulimi i një strukture teorike të pavarur nga nevoja *a priori* për vërtetimin e së njëjtës arsye të ndërgjegjes.

Nga ana tjetër, ata që besojnë në harmonizimin e mendimeve me natyrën e tyre të brendshme, përpiqen të theksojnë sa më poshtë:

- *Musted'afin*-ët (skamnorët ekonomikisht dhe masat e shtypura, të privuara a të dobëta parë nga aspekti socio-religjioz, politik, kulturor dhe edukativ), si një faktor shkaktar, përfshirë edhe ata që kanë domethënie etike, fetare, artistike, kulturore dhe shkencore.

- Theksimi nga koha në kohë e arritjes së vlerave njerëzore, si qëllimi i fundit i përpjekjeve individuale dhe kolektive.

- Theksimi i përpjekjeve njerëzore për arritje sa më cilësore.

- Mënjanimi, kur dhe nëse është i nevojshëm, i papajtuësmerive të sjelljeve të gjithsecilit, në një kuptim të njëjtë me ndërgjegjen e qëndrueshme të gjithsecilit, duke siguruar zbatim të vazhdueshëm.

Shpjegimet e mësipërme janë bërë për të hedhur poshtë dhe për të bërë të pavlefshme dy teoritë ose postulatet.

Postulati i parë ishte që, pavarësisht nga shfaqjet e jashtme,

të gjitha revolucionet kanë të njëjtin thelb. Kjo ishte për shkak të origjinës së tyre të përbashkët, e cila mund të përcaktojë klasat ekonomike të njerëzve në një shoqëri. Rrjedhimisht, diferencimet klasore mund të çojnë në ndryshime manipulatore në kuptim të prodhimit, që rezultojnë polaritet në një shoqëri, i cili mund të kthehet në një revolucion shoqëror. Teoria e dytë duket se thekson se revolucionet nuk janë të njëjta.

Tani le të testojmë dhe të analizojmë më tej teorinë e mësipërme, në kontekstin e vlerësimit të Revolucionit të Iranit.

Sipas teorisë së dytë, të përmendur më lart, një revolucion mund të marrë pjesë pa përfshirë faktorët ekonomikë të prodhimit. Kjo është në kuptimin që faktorët e përmendur nuk e kanë arritur shkallën e zhvillimit dhe kjo shkallë nuk është bërë aktive. Mundësi të tjera, gjithashtu, janë jo efektive dhe nuk ekzistojnë. Orientimi klasor i një shoqërie është një mundësi negative.

Si alternativë, mund të përmendim fjalët e Hazretit Ali (a.s.): “Velja’ e shtypësve dhe ‘uria’ e të shtypurve janë në raporte shqetësuese.” Edhe kur ky polarizim merr një rëndësi të konsiderueshme, kjo nuk ndodh për shkak të ndonjë roli të rëndësishëm që luhet nga të shtypurit.

Në të vërtetë, të shtypurit nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në trazirat që çuan në hyrjen e Hz. Aliut (a.s.) në zyrat e Kalifatit. Ai e mori vetë detyrën, duke marrë parasysh se shoqëria islame ka ardhur duke u ndarë nga rregullat e klasës despotike, nga rregulla që janë shtypëse dhe privuese. Kjo ndodhi pavarësisht nga fakti se vetë Kalifi i përket klasës së të shtypurve.

Jeta e thjeshtë dhe modeste e Aliut (a.s.) nuk i përkiste asnjë statusi ekonomik apo ndarjeje klasore.

Sërish, siç tregojnë edhe teoria e dytë, një revolucion social mund të lindë pa pasur nevojën që të udhëhiqet nga klasa e shtypur dhe e dobët. Por të gjitha elementet shoqërore, grupet apo klasat, përfshirë edhe tregtarët, mund të tërhiqen nga shkaku (ose shkaqet) që shpien në revolucion.

Teoria e dytë, gjithashtu, postulon që qëllimi i fundit

i përpjekjeve njerëzore mund të jetë përtej çdo arritjeje të mirëqenies materiale. Kjo mund të jetë në terma të besimit dhe të arsyes shpirtërore apo intelektuale. Në të vërtetë, klasa e shtypur e një shoqërie mund të jetë kundërshtues ndaj çdo lloj interpretimi të demonstratave publike dhe përcaktimit të tyre si diçka që nuk kërkon më tepër se sa të përfitojë të mira materiale.

Arsyet intelektuale dhe shpirtërore ose normat tradicionale mund të thirren gjithmonë nga çdo lider i aftë i shoqërisë. Rrjedhimisht, një armik mund të dojë të shkatërrojë të njëjtën gjë. Në një tjetër rast, sensi i nderit dhe i drejtësisë së ndërgjegjes së njerëzve është i përfshirë. Në këtë mënyrë, mund t'i jepet shkas ndërprerjes së zhurmës apo lëvizjeve të qëndrueshme. Madje edhe mund të manifestojë vetveten në entuziazmin revolucionar, pa pasur asnjë arsye të pastër materialiste apo ndonjë shpjegim. Shpesh, është e lidhur me besimin e njerëzve, me idetë e tyre kuptimplota, me dëshirat njerëzore apo me një sërë parimesh apo personalitetesh të papërmbajtura.

Çdo analizë e revolucionit iranian, në bazë të teorive të sipërpërmendura, duhet të marrë në konsideratë:

- identifikimin e individëve apo grupeve që marrin përsipër revolucionin;
- gjurmimin e çështjeve më të rëndësishme, që çojnë drejt revolucionit apo zhvillimit;
- studimin e qëllimit të revolucionit;
- përditësimin e sloganeve dhe motiveve të revolucionit që paraqesin dinamizmin e jetës;
- analizimin e rolit të liderëve të revolucionit dhe të udhëheqjes;
- shpejtësinë e promovimit të revolucionit, duke i kushtuar vëmendje faktit që nuk i përket asnjë klase të përcaktuar apo grupimi shoqëror.

Për sa u përket shkaqeve kryesore të revolucionit duhen rishqyrtuar atë që është shpallur këto pesëdhjetë vjetët e fundit në Iran, ku përfshihen:

- despotizmi dhe neokolonializmi;
- të mbajturit e fesë jashtë politikës;
- përpjekja për të rilindur zakonet dhe traditat paraislame;
- venitja e traditës së çmuar islame;
- vrasjet e pamëshirshme;
- çintegrimi i shoqërisë nëpër klasa;
- mbizotërimi i elementeve joislame te myslimanët;
- shkelja e ligjeve islame;
- sulmet ndaj literaturës persiane dhe asaj islame dhe përpjekjet për ta zëvendësuar atë me fjalë të tjera;
- ndërprerja e marrëdhënieve me vendet e tjera myslimane dhe vendosja e marrëdhënieve miqësore me vende antiislame, të tilla si Izraeli;
- propagandimi i marksizmit dhe i koncepteve të tjera materialiste.

Disa nga çështjet dhe situatat e përmendura më lart vijnë nga djallëzitet e materializmit. Të tjerë të përfshirë cenojnë krenarinë e disa personave. Më së shumti, revolucioni është promovuar nga ndjenjat e lënduara të myslimanëve. Për më shumë, edhe dy faktorë të tjerë janë përfshirë në revolucion. Njëri është zhgënjimi nga liberalizimi ose toleranca perëndimore dhe tjetri është mungesa e shpresës ndaj socializmit lindor.

Sipas rrethanave të mësipërme, shumica myslimane e Iranit, e mirinformuar për atë çka kërkon, synon të realizojë kërkesat e saj për të fituar identitetin islam dhe për të rikthyer vlerat islame. Kjo shënon fundin e asaj faze të historisë ku ata e shihnin veten si të pavlerë dhe të shtypur. Tashmë kanë hyrë në një epokë të rikthimit të vlerave dhe të ndërgjegjes islame. Kjo ndërgjegje islamike e sapozbuluar është po ashtu e aftë për të bërë në mënyrë emergjente vendet islamike dhe joislamike të “Botës së tretë”, efektive *vis-a-vis* atyre të Blloqeve Perëndimore dhe Lindorë.

Çështja gjithëpërfshirëse e revolucionit në Iran është me natyrë dhe përmbajtje islamike. U mor përsipër nga individë të mbushur thellësisht me këtë ndjenjë të re zgjimi dhe manifestimi

të shpirtit islamik dhe përmbajtjes ideologjike. Në kohërat tona ne kemi parë një lloj zgjimi të ndërgjegjes islame ndër myslimanë në të gjithë botën. Ky rizbulim i identitetit të tyre të vërtetë dhe të natyrës së tyre islame, pashmangshmërisht ka ndjekur përballje ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, për sa u përket vlerave dhe shkollave të mendimit. Në kontekstin e mësipërm, fjala e përbërë “vetëmposhtje” ka nevojë për një shpjegim. Ajo është rezultat i:

- një personaliteti njerëzor të paqëndrueshëm;
- keqbesimit në vlerat njerëzore;
- humbjes së vetvetes në vetëkënaqësi;
- humbjes së respektit ndaj vetes;
- druajtjes dhe mungesës së besimit në kulturën tonë, në kompetencat dhe në përsosjen tradicionale.

Nga ana tjetër, asnjë përpjekje për “vetëmposhtja” nuk është përfshirë në mirëbesimin, respektin për veten dhe vlerësimin për formimin historik dhe kulturor të secilit prej nesh.

Analizimi i natyrës dhe i përmbajtjes së Revolucionit të Iranit nuk është i ndryshëm nga analizimi i udhëheqjes. Në çdo rast, është e përfshirë edhe njohja e vetvetes. Si është e mundur që udhëheqja e Imam Khomeinit është pranuar gjerësisht nga shumica? Kjo pyetje mund të bëhet duke pasur parasysh se sido që të jetë hapësira dhe mbulimi i kundërshtimit ndaj tij, në terma të ideologjisë dhe të politikës, askush nuk refuzon për ta njohur udhëheqjen e tij.

Megjithatë, pse, njerëzit preken vërtet nga fjalimet e tij? Dhe pse deklaratat e tij kanë një ndikim tek elitat? Kjo, gjithashtu, është nën dritën e mungesës së mjeteve, mundësive dhe ekzistencës së kundërshtarëve që bashkëpunojnë për të ulur dhe/ose për të shtrembëruar rëndësinë e fjalëve të tij, si dhe kërcënimeve të tyre për torturë, vdekje dhe shkatërrim.

Nuk ka dyshim se Imami ka shfaqur shpirtin e tij të pamposhtur dhe e ka pasqyruar atë në përpjekjet e tij kundrejt shtypësve. Mbështetja e tij ndaj të shtypurve ka qenë efektive dhe reciproke në të njëjtën kohë. Për më shumë, sinqeriteti i

tij çarmatosës, besimi i qëndrueshëm vërtetësia dhe kurajoja morale kanë pasur një ndikim të madh. Të gjithë e dinë se Imami nuk i pëlqen njerëzit që veprojnë në keqbesim apo në mënyrë armiqësore. Të gjitha këto dhe shumë cilësi të tjera të Imamit kanë qenë të rëndësishme për njohjen e udhëheqjes së tij. Tashmë bazat e kësaj udhëheqjeje qëndrojnë diku tjetër.

Baza më e rëndësishme e udhëheqjes së Imam Khomeinit është saktësia dhe artikulumimi kuptimplotë i asaj që masat kanë në zemrat e tyre. Ajo që thotë ai nga thellësia e zembrës së tij, prek të gjitha zemrat e njerëzve. Prandaj, ai ripërsërit parimet dhe vlerat e paçmuara, që ruhen në kulturën tonë islame, në historinë dhe në thellësi të shpirtit tonë.

Përgjatë katërmbëdhjetë shekujve të fundit, njerëzit tanë i kanë ruajtur me shumë përpikëri thëniet frymëzuese të Profetit Muhamed (s.a.s.). Ata, gjithashtu, kanë vlerësuar aftësitë e udhëheqjes, cilësitë dhe heroizmin e Prijësit të Besimtarëve (*Emiru'l-Mu'minin*), Aliut (a.s.), të Hz. Fatimesë, Imam Husejnit (a.s.) dhe Hz. Zejnebit, po ashtu edhe Selmanin dhe Ebu Dherrin, si dhe qindra të tjerë të devotshëm, burra dhe gra që janë bërë shembull për njerëzimin.

Të gjitha vlerat kuptimplota dhe revolucionare të Islamit dhe të traditave janë thithur nga brezat pasardhës të njerëzve tanë, aq shumë sa ata janë bërë një pjesë natyrore e jetesës së tyre individuale apo kolektive dhe një forcë motivimi për ta. Pa asnjë dyshim, kur ata kanë dëgjuar një zë të një lideri islam të së shkuarës, menjëherë duan që ai të bëhet pjesë e tyre. Kjo bëri që ata të bashkoheshin me Hz. Aliun (a.s.) dhe Imam Husejnin (a.s.) dhe të gjenin tek ata imazhet që kërkonin. Me fjalë të tjera, ata arritën të shihnin në personalitetin e tyre gjithçka kishin trashëguar dhe mund të merrnin nga e kaluara e tyre e shkëlqyer islame.

Çfarë bëri Imam Khomeini për të arritur në lartësinë e duhur?

Ai u dha njerëzve tanë identitetin dhe karakterin e tyre të vërtetë. Ai i solli ata në të kuptuarin e vlerave të tyre islame.

I çliroi nga vetëmposhtja dhe sjelljet e tyre. Në të vërtetë, ai i zgjoi ata të reagonin ndaj një kulture të huaj që po “u merrte frymën” apo nga gjendja e *istisba'*-it.¹⁶

16. Fjala arabe “استسباع” përdoret idiomatikusht në filozofinë islame. Përkthimi literal në persisht rrotullohet rreth “një gjendje shushatjeje”. Thuhet se kafshë të vogla vihen përballë kafshëve më të mëdha (për shembull, një lepur i vogël përballë luanit), ngatërrohen dhe si rrjedhojë nuk gjejnë asnjë mënyrë për të shpëtuar. Ata humbasin aftësinë e tyre për të vepruar dhe bëhen të nënshtruar dhe të paftë.

Fraza: Të kesh besim në vetvete është e kundërta e vetënështrimit. Gjatë jetës së Profetit (s.a.s.) një nga ndjekësit e tij kishte nevojë të skajshme për ndihmë. Përpara se ai të bënte kërkesën e tij, e dëgjo Profetin të fliste në një mbledhje, që kishte të bënte me njerëzit që kërkonin ndihmë. Megjithatë, ata që e mbështesin besimin e tyre në Zot dhe tregojnë qëndrueshmëri për ta mbajtur një besim të tillë, ajo çka ata kërkojnë, do t’u vijë nga hiri i (mirësia e) Zotit, pa dyshim.

Sapo dëgjo bisedën e Profetit, njeriu i varfër u largua pa thënë asnjë fjalë për gjendjen e tij. Brejtja e ndërgegjesje e detyroi atë njeri që të kthehej sërish aty ku ishte Profeti një ditë më parë, vetëm e vetëm për të gjetur të njëjtin diskutim për të njëjtën çështje, si dhe një ditë më parë. Pastaj ai tha: “Pse të mos veproj sipas porosisë së Profetit?” Kjo e bëri atë edhe më të vendosur për të gjetur një punë fitimprurëse nga mirësia e Zotit. Ai u kthye në shtëpi dhe mori borxh një sëpatë dhe një litar nga fqinji i tij. Dhe kështu filloi të priste pemë pranë një pylli. Pas disa ditësh vetëpunësimi, ai fitoi vetëbesim dhe kushte më të mira ekonomike.

Në rastin e mësipërm, Profeti (s.a.s.) theksoi faktin e aftësive të njerëzve, që me fuqinë, dinamizmin dhe mundësitë që u ofrohen, të mund t’i largojnë kushtet e vështira të jetesës. Shpesh, banorë të disa vendeve konsiderohen si të pavetëdijshëm nga banorë të disa vendeve të tjera. Në këtë rast, banorët e këtyre vendeve mund të arrijnë deri në zhvlerësim të vlerave të tyre dhe në përkrahjen e vlerave egoiste të atyre që i nënshtruan.

Vendi ynë, gjatë regjimit të Shahut, ka parë shumë situata të ngjashme me atë të përshkruar më lart.

Vendet që zhvillojnë një sjellje servile, harrojnë aftësitë e tyre të vërteta, me të cilat mund të arrijnë të bëjnë mrekulli. Kushtet e tyre mund të shkojnë deri në atë pikë, sa të bëhen vartës të asaj që u kërkojnë të tjerët. Në një situatë të tillë të padëshirueshme, njerëzit e zënë “rob” mund të gjejnë kënaqësi perverse në plotësimin e atyre që u kërkohet nga ata që i sundojnë. Në shembujt historikë të rezistencave të suksesshme tregohet se disa njerëz e ruajnë dhe e ringjallin besimin e tyre. Në këtë kontekst, sakrificat heroike dhe përpjekjet e këtyre njerëzve janë një shembull shumë i mirë. Njerëzit tanë, të udhëhequr nga guximi i qëndrueshëm dhe vizionar i Imam Khomeinit, u është bërë e

Shërbimi më i madh i Imam Khomeinit ndaj njerëzve ka qenë çlirimi i shpirtave të tyre të “pushtuar”. Ai bëri të mundur që njerëzit të ktheheshin te besimi i tyre i humbur dhe të ripohonin besimin e tyre dhe të kuptonin se çfarë ishte e drejtë. Në mënyrë të veçantë, u solli atyre mesazhin se Islami siguron një strukturë ideologjike unike për shpëtimin e njerëzve.

Ai propozoi shpëtim përmes mundimeve të *xihad*-it islam, në nivel individual dhe shoqëror. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se ajo çka është thellësisht e mirë, duhet të mbështetet në çdo kohë dhe në çdo vend.

Anasjelltas ajo çka është e dobët, duhet të kundërshtohet në mënyrë të vazhdueshme. Për më shumë, ai ka theksuar nevojën për një shpërblim të drejtë për *shhid*-ët – martirët e pashembullt dhe për jetët e tyre. Për këtë arsye, janë theksuar shumë veprime që do të ndërmerren nga individët, por edhe nga shoqëria.

Ajo çka njerëzit tanë kanë kërkuar gjithmonë ndër shekuj është mirënjohja e thellë dhe zilia për ata që kanë mundur të bashkohen me legjionin e martirëve të udhëhequr nga Imam Husejni (a.s.). Ata luten në mënyrë të vazhdueshme:

“O Zot, sikur vetëm unë të isha njëri nga ata, do të arrija shpëtimin e premtuar, gjithashtu!”

Në angazhimin e tyre të thellë për atë që Imam Husejni (a.s.) përfaqësoi, njerëzit tanë i kanë ngjallur vazhdimisht ngjarjet e Kerbelasë, Hunejnit, Bedrit, Uhudit, Tebukut, Khajberit dhe të tjerave të ngjashme. Në këtë mënyrë, ata kanë qenë të aftë të arrijnë vetëpastrimin dhe dashurinë e pafundme për Zotin dhe të qëndrojnë të paepur ndaj shtypjeve dhe mizorisë, duke përsëritur në mënyrë të sinkronizuar thënien *“Allahu Ekber!”* - Zoti është më i Madhi! .

mundur që të rifitojnë besimin në vetvete, si pjesë të së kaluarës së tyre islame. Ky vetëbesim solli një revolucion fitimtar.

-VII-

Sa mirë mund të zgjerohet dhe të forcohet Revolucioni Islamik në Iran?

Intervistuesi: Pyetja e fundit është: Si mund të jetë i qëndrueshëm ky revolucion dhe të anashkalojë dobësitë e tij, të forcohet dhe të zgjerohet në baza të qëndrueshme, që të mos kishte asnjë mundësi për t' u rikthyer *status quo ante*, apo në ndonjë zhvillim tjetër që do të sillte një situatë të padëshirueshme?

Mutahhari: Siç duket, do të ishte naive të fshehësh atë që ndërkohë është e përplotësuar si një e fundit në vetvete. Kjo është kryesore, për shkak të ndikimit negativ të regjimit të kaluar. Negativiteti është i dallueshëm në institucionet ekzistuese socio-ekonomike dhe në mungesën e efikasitetit të tyre.

Pasqyrohet në natyrën vetëzhgënjyese të efekteve mbizotëruese të kulturës imperialiste. Është kryesisht e manifestuar në sistemin qeverisës dhe në organizatat e korruptuara dhe të keq qeverisura. Të gjitha këto handikape sjellin ende një efekt negativ.

Shkurtimisht, njerëzit tanë duhet të përpiqen ende për të çmësuar të gjitha gjërat negative, të grumbulluara gjatë imperializmit të diktatorëve dhe politikëbërësve *Shahinshah-ë* apo *Aryamehr-ë*.

Rrjedhimisht, është i dukshëm ndikimi i problemeve ekzistuese që nga e shkuara. Është e rëndësishme të përfshihen të gjitha ndryshimet e nevojshme, për të zhdukur ndikimet negative kulturore, botëkuptimin kolonialist dhe gjurmë të tjera të ngjashme me regjimin e mëparshëm.

Në kontekstin e mësipërm, është e dukshme që, disa grupe të keqmotivuar, janë ende si helmi, që përpiqen ta kthejnë vendin

në *status quo*-në e mëparshme. Disa grupe të tjera, me prirje të majta, ekzistojnë ende, por kanë pikëpamje që ta shmangin kursin e revolucionit drejt socializmit apo komunizmit. Të tjerë janë duke pritur për të filluar një lëvizje të një tipi agitacioni kushtetues, si model i së ashtuquajturës lëvizja e “nacionalizmit iranian” dhe ajo e pavarësisë së Irakut.

Degëzimet e përmendura janë përsheptuar dhe po presin për dëbimin dhe diskreditimin e autoritetit islam, gjerësisht nga liderët fetarë, pasi të largohet regjimi i mëparshëm.

Në librin tim *Nahdat'ha-je Islami Sadsale Akhir (Islamic Movemens during the last hundred years)*¹⁷, unë kam diskutuar problemet që lidhen me revolucionet. Shpjegimet e bëra lidhen drejtpërdrejt me kontekstin e pyetjes suaj, se si mund të mbrohet sa më mirë interesi dhe qëllimi i revolucionit.

Problemet e diskutuara në librin e lartpërmendur mund të përmenden edhe këtu. Ato janë një ngulmim i ndikimeve të ndërsjella të ndërhyrjeve të kulturave të huaja, pengim i vendosmërisë së njerëzve për të shkuar drejt procesit të islamizimit, thyerje e procesit të punës nga kërkuesit e kënaqësive dhe oportunistët e vendosur në pozicionet kyçe, të cilët, me ekstravagancë, synojnë të ndikojnë në të ardhmen.

Megjithatë, natyra e ndërlikuar e problemeve të mësipërme ka bërë që njerëzit të reagojnë sipas mënyrës së tyre më të mirë: të forcojnë besimin. Kjo i lejon ata të vetëbesojnë, ndërkohë që përpiqen për të rizbuluar dhe për të zgjeruar karakterin dhe vlerat e tyre islame.

Nëse Lindja zgjohet dhe rizbulon fuqinë e tij islame në këtë proces, kjo nënkupton se as bombat atomike nuk do të kenë asnjë dobi, nëse përballen me fuqinë dhe vendosmërinë e masave. Sapo popujt e Lindjes të gjejnë vetveten dhe të vendosin me forcën e tyre, askush nuk do të mund t'i pengojë arritjet e tyre të mëtejshme.

Rruqa drejt një zgjimi dinamik të masave lindore është në

17. Murteza Mutahhari, *Islamic Movements in Twentieth Century*, Fondacioni “Be'thet”, Teheran, 1981.

përputhje me origjinalitetin e tyre (postislam dhe parakolonialist) historik dhe qëndrimet kulturore, si dhe me perspektivat dhe kriteret ideologjike.

Në një mbledhje të fundit publike, një student më pyeti se përse Islami nuk i çliroi më përpara njerëzit, nëse ai ka qenë i aftë për të bërë një gjë të tillë përgjatë katërmbëdhjetë shekujve. Si përgjigje, unë theksova se kjo ka ardhur vetëm si rezultat i mosdijes sonë rreth Islamit, qoftë edhe në perspektivën historike. Shumë prej nesh e kanë lënë ende veten e tyre të paditur ndaj faktit historik që Islami, përgjatë pesëqind viteve të para, ka qenë i aftë të zhvillojë një ndër qytetërimet më të mrekullueshme që ka njohur historia e njerëzimit.

Mungesa e njohjes të së shkuarës islame ka qenë një ndër arsyet kryesore që e ka mbajtur të bllokuar dhe joproduktiv zhvillimin kulturor të sotëm. A kemi qenë ne të aftë për të mbrojtur dhe për të realizuar identitetin tonë kulturor islam (pavarësisht nga tentativat kolonialiste) do të kishte qenë e pamundur për çdo fuqi imperialiste/kolonialiste të ditëve të sotme të na shfrytëzonte dhe të na shtypte.

Kërkesat e para ishin që fuqitë imperialiste dhe kolonialiste të na shtypnin dhe t'i detyronin njerëzit tanë që të largoheshin nga objektivat dhe trashëgimia e tyre kulturore. Ky plan djallëzor u mendua të zbatohet përmes një procesi përçarës dhe subjektivist, që synonte t'i riorientonte ata (p.sh., në kuptim të shteteve-kombe/kombësive), që të sillte ndasi ndërmjet tyre dhe largim nga mjedisi i tyre i përbashkët islam.

Një shembull mjaft i dukshëm është puna e mendjeve të tjetërsuara të Shahut të mëparshëm, të cilat menduan të festonin 2500-vjetorin e regjimit monarkik në Iran. Regjimi i mëparshëm, në mënyrë të vazhdueshme, ka synuar të minojë identitetin islam, siç mund të shihet dhe nga një tjetër shembull i përvojës sime personale.

Husejnije Irshad (qendër e famshme kulturore islame në Teheran) ishte e detyruar të përballlej me regjimin e mëparshëm

islam, për të realizuar aktivitetet islame. Edhe programet rutinë, për të mos folur këtu për leksionet që jepeshin atje, nuk lejohej të botoheshin në gazeta. Një përjashtim nga ky kufizim u vu re kur në një program dyjavor që do të organizohej, ishte përcaktuar që unë të mbaja një fjalim, në lidhje me incidentin e djegies së librave në Egjipt dhe Iran, në mënyrë që të “demaskohej” autenticiteti i tyre.

Mirëpo, në vigjilje të mbajtjes së leksionit tim, njerëz të interesuar nxituan për të parë lajmërimet në gazetatat lokale. Nga kërkimet tona rezultoi se njoftimi nuk ishte miratuar. Më përpara ne nuk kishim mundësi që të përmendnim episodin e djegies së librit nën botim *Khadamat mutekabil Iran ve Islam (Mutual Contributions of Iran and Islam)*. Për ta botuar atë, u dha leje vetëm nëse ne do të fshinin episodin e djegies së librit nga materiali.

Pa asnjë dyshim, regjimi i mëparshëm ka tentuar për vite të tëra të ushqejë propagandë antiislame, për të treguar se Islami jo vetëm që dështoi të zhvillonte një qytetërim, por shkaktoi shkatërrimin e qytetërimeve antike.

Deri më tani, faktet historike janë të tilla që myslimanët shkëlqyen në mbarë botën gjatë pesë shekujve të parë, në kuptim të arritjeve intelektuale, shkencore dhe kulturore. Epërsia e tyre është e njohur edhe në ditët e sotme aq shumë, sa dijetarët europianë ia atribuojnë rrënjët e qytetërimit dhe kulturës së tyre edhe Islamit.

Bazuar në kërkimet e mia, unë jam bindur në diçka që filozofia sociologjike e Islamit në kontekstin e saj përparimtar ka mbetur më progresive sesa filozofia e jetës që ka mbizotëruar në Perëndim.

Kështuqë, përgjigja ime dhënë pyetjes së ngritur nga studenti-vëllai, mund të përmbliidhet që po të ishte e vërtetë se Islami dështoi për të prodhuar një civilizim të denjë për emrin, që nga lindja e tij katërmbëdhjetë shekuj më parë, çdo perceptim i dobët në fe pyetjen e tij mund ta nënkuptonte apo ta konsideronte se do të kishte qenë e drejtë.

Në kontekstin e rilindjes islame, ne duhet të rikujtojmë filozofinë e *vetvetes* të Iqbal Lahorit (dhe zgjerimin e tij) që është bërë për të lejuar myslimanët të riorientojnë vetveten përgjatë jetës të tyre islame. Suksesi i padiskutueshëm i lëvizjes sonë islame mbështetet gjithashtu në vetëzbulimin e vetvetes nga njerëzit tanë dhe në rrënjosjen e vlerave origjinale islame. Përgjatë realizimit të vlerave islame, ne duhet të rivlerësojmë qëllimet dhe pritshmërinë tonë, në mënyrë të saktë me rregulloret dhe konceptet islame. Në bazë të këtij rivlerësimi, ne duhet të riorientojmë veten tonë drejt parimeve të paçmuara të Islamit.

Orientimi drejt Islamit është një proces që do shumë kohë, durim dhe këmbëngulje, ashtu siç edhe parashihet në Islam. Kjo mund të arrihet me anë të shpirtit islam të *xhihad*-it (vetëmbrojtja e myslimanëve dhe mundimet e vazhdueshme për të arritur të drejtën në rrugën e Zotit), që thërret për vendosmëri dhe për vendosjen e së drejtës dhe të ndershmërisë. Në të njëjtën kohë, ajo kërkon mund të papërkulshëm ndaj falsitetit dhe dobësisë. Vetëm nëpërmjet *modus operandi*-t islam, suksesi ynë do të jetë i padiskutueshëm.

Sipas myslimanëve kudo nëpër botë duhet të njihet nevoja për vetëbesim, bazuar në fuqitë e tyre të brendshme dhe konstruktive, si dhe në besimin pozitiv në Mëshirën dhe Mbrojtjen Hyjnore. Pra, pa vetëbesim dhe kërkim të fesë, nuk do të mundemi ta çlirojmë veten tonë nga ndalimet dhe shtrëngimet e shtypësve neokolonialistë.

Një çështje që do të konkretizonte sa thamë, është "pashtetësia" e palestinezëve. Një faktor në vonesën e lëvizjes palestineze/myslimane janë përfshirjet dhe mbështetja te komunistët. Sakrificat e tyre të çmuara dhe vuajtjet e vazhdueshme kanë nevojë për kohë, që të bëhen të mjaftueshme për të siguruar suksesin e lëvizjes së tyre. Qëllimi i tyre ka qenë i ndryshëm nga përpjekjet e Revolucionit Islamik në Iran.

Vuajtjet dhe martirizimi (*shihadet*) i të rinjve iranianë myslimanë nuk ka qenë pa vlerë. Përkundrazi, vuajtjet e tyre

i kanë lejuar myslimanët e tjerë të forcojnë më tepër përpjekjet e tyre për të arritur suksesin përfundimtar. Rrjedhimisht, përpjekjet e myslimanëve iranianë tashmë kanë arritur pushtet. Nëse përpjekja e tyre nuk do të ishte mbështetur në Islam, nuk do të kishte qenë kaq e suksesshme. Do të kishte qenë e tillë sikur myslimanët të luftonin si mercenarë jomyslimanë, me një qëllim vetjak për jetët e tyre dhe për të mirën e familjeve të tyre.

Martirët e Iranit kanë njohur përmbajtjen islame të asaj që i priste (*shehadet*) dhe e kanë përqaftuar gjerësisht. Ata gjithashtu ishin të ndërgjegjshëm për interpretimet sekulariste dhe keqinterpretimet që do të bënin disa grupe. Fakti që ata ishin të prirur për martirizim, thekson dëshirën dhe bindjen e tyre të thellë se regjimi nuk duhet të lejohet të bjerë në duart e grupit që është i çorientuar dhe larg botëkuptimit islam. Ata myslimanë, në Iran ishin gjithmonë të lidhur ngushtë me Islamin dhe kundërshtonin armiqtë e tyre, gjë që u bë një fakt në regjimin e shkuar, kur ai vendosi të bllokonte revolucionarët myslimanë, duke i quajtur “marksistë islamë”.

Në të vërtetë, komunizmi dhe imperializmi janë si tehet e gërshërës, të cilat duket sikur veprojnë në të kundërt, por aktualisht vijnë bashkë dhe e presin pëlhurën. Historia bashkëkohore ka shumë shembuj të bashkëveprimit imperialist dhe komunist.

Në përfundim, unë mendoj se tashmë ka ardhur koha që të trumbetojmë për të gjithë myslimanët, që ata të fillojnë të kërkojnë rizbulojnë identitetin e tyre kulturor islam. Nuk ka asnjë dyshim se jehona e kësaj thirrjeje do të ndihet edhe nga vëllezërit e tjerë myslimanë. Pastaj nuk do të jetë e largët koha kur do të thyhen zinxhirët e skllavërimit dhe të fillojmë të ndjekim drejtimin tonë dhe të jemi dëshmitarë të rishpalljes së fuqive dhe vlerave të myslimanëve në procesin e zgjimit islam.

Intervistuesi: Profesor, ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë intervistë televizive.

Profesor Mutahhari: Faleminderit për mundësinë.

نام کتاب: پیرامون انقلاب اسلامی

نویسنده: مرتضی مطهری

مترجم: ادلیرا عثمانی

ویرایش: دورینا باشا

مقابله: یتمیر چلا

صحافی: فاطمیر شوتینا

ناشر: جمعیت النسیم

تیرانا: ۲۰۱۴